



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2497/7 prot

Datë 13/11/2025

V E N D I M
Nr. 1667/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13/11/2025 u shqyrtua ankesa me

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Anbim” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-51165-06-13-2025 me objekt “Blerje mjete pastrimi” me fond limit 12,583,334 (dymbëdhjetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e katër) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 22.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Anbim” SHPK, “Euro Mega 2010” SHPK si dhe lënien të skualifikuar dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit për operatorin ekonomik “Besim Kamberi” PF në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-51165-06-13-2025 me objekt “Blerje mjete pastrimi” me fond limit 12,583,334 (dymbëdhjetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e katër) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 22.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Kamëz
Adresa: Bulevardi “Nënë Tereza” Nr. 492, Kamëz, Tiranë.

Ankimues: Operatori Ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK, me NUIS K91624505A, me adresë Fshati Ahemtaq, prane firmës Ital Kon, Prezë, Tiranë.

Operatori Ekonomik “Malvina Visoka” PF, me NUIS L61608005C, me adresë Rruga “Muhamet Veliu”, Pallati 3D, Njesia me Nr. Pasurie 475/103-G15, ZK. 2460, Tiranë.

Subjekte të Interesuara: Operatori Ekonomik “Anbim” SHPK me NUIS L81618008J, me adresë: Autostrada Tr-Dr Km 1, Zona kadastrale 2679 Numri pasurise 40/55, Tiranë.

Operatori Ekonomik “Besim Kamberi” PF, me NUIS L42103023G, me adresë Magazinat e Buka sha, Rruga e Qelqit, Zona Kadastrale Nr 3866 Nr Pasurie 310/20 Kashar, Tiranë.

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetura në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

1.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

1.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

1.5. Operatorët ekonomikë ankimues kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 16.06.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-51165-06-13-2025 me objekt “*Blerje mjete pastrimi*” me fond limit 12.583.334 (*dymbëdhjetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e katër*) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 22.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

II.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike, rezulton se në datën 08.09.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit përfundimtar të ofertave si vijon:

1. “Anbim” SHPK	7.870.911	lekë	kualifikuar
2. “Besim Kamberi” PF	7.993.803	lekë	skualifikuar
3. “Euro Mega 2010” SHPK	7.999.000	lekë	kualifikuar
4. “Malvina Visoka” PF	8.418.280	lekë	kualifikuar
5. “Leon Group” SHPK	9.209.548,17	lekë	kualifikuar
6. “Atlantik 3” SHPK	10.999.445	lekë	kualifikuar

II.3. Në datën 09.09.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE njoftimin e fituesit të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.4. Në datën 15.09.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5806 dhe nr. 2497/2025 protokolli, datë 16.09.2025 e operatorit ekonomik “*Euro Mega 2010*” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Anbim*” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit me argumentat si vijon:

“Pasi u njohem me vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me vlerësimin e ofertës të ofertuar nga operatorët ekonomikë “ANBIM” SHPK vlerësojme se, oferta e këtij operatori ekonomik duhet të skualifikohet për arsyet e mëposhtme për kualifikim:

I- Nuk ploteson kriterin për kualifikim të përcaktuar në pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik të shtojcës 8 të DT-se me përmbajtjen si vijon:

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues për produktet objekt prokurimi me nr. 1, 2, 3 në tabelën e Shtojcës 7, duhet të paraqesë dokumentin me të dhënat e sigurisë (MSDS) të lëshuara/publikuara nga prodhuesi/it dhe Certifikatën e Konformitetit CE (Kur është e aplikueshme).

II- Nuk ploteson kriterin për kualifikim të përcaktuar në pikën 2.3.5 të shtojcës 8 të DT-se:

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostrat (kampionet) ditën e hapjes së ofertave, nga jo më pak se 1 (një) kampion për mallrat objekt prokurimi, për artikujt e kërkuar në shtojcën 7, përkatësisht me nr.rendor 1 deri në 20, 26, 28, 38, 40, 42, 43, 44, 45.

Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik.

- Mostra duhet të jetë për të gjithë artikujt e kërkuar, objekt i këtij prokurimi.
- Mostrat duhet të jenë të njëjta me ato të ofruara nga operatori ekonomik ofertues në dokumentacionin teknik të paraqitur në sistemin e publikimeve elektronike (SPE).

Sa me sipër argumentojme:

Shoqëria “Euro Mega 2010” SHPK, është një kompani e cila ndër të tjera aktivitetet e saj kryesor ka prodhimin dhe tregtimin e detergjenteve e cila operon në treg prej vitit 2009, pra prej një kohe të gjatë dhe për pasoje njeh mirë tregun e fushës objekt i këtij prokurimi si dhe konkurrentet e saj në këtë fushë, kapacitetet aftësitë e tyre si në përgatitjet e ofertave ashtu edhe kapacitetet e tyre në fushën e tregtimit apo prodhimit të detergjenteve.

I- Në lidhje me pretendimin tonë se ofertuesi “Anbim” SHPK, nuk ploteson kriterin për kualifikim të përcaktuar në pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik të shtojcës 8 të DT-se me përmbajtjen si vijon:

“2.3.4 Operatori ekonomik ofertues për produktet objekt prokurimi me nr.1, 2, 3 në tabelën e Shtojcës 7, duhet të paraqesë dokumentin me të dhënat e sigurisë (MSDS) të lëshuara/publikuara nga prodhuesi/it dhe Certifikatën e Konformitetit CE (Kur është e aplikueshme).”, paraqesim argumentat tona si më poshtë vijojnë:

Në besojmë se ofertuesi “Anbim” SHPK, nuk ka arritur të vërtetojë se ploteson të gjitha kërkesat e përcaktuara nga AK-ja në pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik të shtojcës 8 të DT-se, pasi ky ofertues nuk ka paraqitur dokumentacionin provues në lidhje me Certifikatën e Konformitetit CE (Kur është e aplikueshme), për artikujt me numra rendore 1, 2 dhe 3 në tabelën e shtojcës 7 të DT-se.

AK-ja për artikujt me numra rendore si: 1(Solucion lares dyshemeje (pllakash)); 2 (Detergjent lares xhamash) dhe 3 (Sapun i lengshëm për duart) nuk ka paraqitur dokumentacionin provues në lidhje me certifikatat e konformitetit CE për këto artikuj.

Referuar legjislacionit të prokurimit publik, ofertuesit janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje të plote me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Një nga parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. [...]

Per gjithe sa me siper kerkojme skualifikimin e ofertes se praqitur nga ofertuesi “Anbim” SHPK per mosplotesimin e kerkesave te percaktuara ne kriterin per kualifikim te percaktuar ne piken 2.3.4 te kapacitetit teknik te shtojces 8 te DT-se.

II- Ne lidhje me pretendimet tona se, ofertuesi “Anbim” SHPK nuk ploteson kerkesat e percaktuar ne kriterin per kualifikim 2.3.5 te kapacitetit teknik te shtojces 8 te DT-se pasi mostrat e dorezuara nga ky ofertues nuk i plotesojne kerkesat e percaktura nga AK-ja per keto artikuj ne shtojcen 6 (Formulari i Specifikimeve Teknike) te DT-se, parashtrojme argumentat tona si me poshte vijojne:

Ne piken 2.3.5 te shtojces 8 te DT-se, AK-ja ka percaktuar:

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostrat (kampionet) ditën e hapjes së ofertave, nga jo më pak se 1 (një) kampion për mallrat objekt prokurimi, për artikujt e kërkuar në shtojcen 7, përkatësisht me nr.rendor 1 deri në 20, 26, 28, 38, 40, 42, 43, 44, 45.

Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik.

- Mostra duhet të jetë për të gjithë artikujt e kërkuar, objekt i këtij prokurimi.*
- Mostrat duhet të jenë të njëjta me ato të ofruara nga operatori ekonomik ofertues në dokumentacionin teknik të paraqitur në sistemin e publikimeve elektronike (SPE).*

Ne shtojcen 6 (Formulari i Specifikimeve Teknike) te DT-se, per artikujt e mesiperm per te cilet eshte kerkuar dorezimi i mostrave, nga AK-ja jane percaktuar specifikimet teknike si me poshte vijojne:

1. Solucion per larjen e dyshemese. Te jete i pershtatshem per vende higjienike, dhoma zhveshje, palestra dhe kudo ku ka probleme arome te pakendshme. Te jete me veti te mira pastruese dhe aromatizuese. Gjendja fizike: te jete solucion leng, me arome parfumi. Vlera e PH te jete 5 deri ne 10. Paraqitja fizike e solucionit te jete homogjene. Tretshmeria ne uje te jete 100%. Densiteti te jete 0.9 gr/cm3-1.1 gr/cm3. Permbajtja e lendeve tensioaktive te jete jo me shume se 10%. Ambalazhimi ne shishe plastike. TE kete emertimin e markes tregtare dhe barkodin e prodhimit te fabrikes.

2. Detergjent per larje xhamash. Te jete me efekt pastrimi dhe shkelqim te xhamave. Gjendja fizike e lengut te jete homogjen, te kete arome parfumi. Vlera e PH 5 deri ne 11. Perberja te jete homogjene dhe te kete densitet 0.9 gr/cm3 deri ne 1.2 gr/cm3. Lenda tensioaktive te varioje nga 1.0% deri ne 4.0%. Ambalazhimi ne shishe plastike me mekanizem sprucimi. Te kete emertimin e markes tregtare dhe barkodin e prodhimit te fabrikes.

3. Sapun i lengshem per duart. Gjendja fizike e lengut te jete solucion viskoz dhe homogjen. Te mos jete irritues me lekuren e duarve. Vlera e PH jo me vogel se 5.5 dhe jo me e madhe se 8. Densiteti i lengut te jete 0.9 deri ne 1.1 gr/cm3. Arome parfumi. Tretshmeria ne uje te jete 100%. Lendet tensioaktive te jene nga 5% deri ne 11%. Ambalazhimi nga fabrika ne shishe plastike me mekanizem ne pjesen e trupit te shishes per manovrim te produktit gjate perdorimit dhe sipas kerkesave te autoritetit kontraktor. Te kete emertimin e markes tregtare dhe barkodin e prodhimit te fabrikes.

4. Pluhur lares per rroba: te kete aftesi vepruese dhe pastruese te larta. Pamja e jashtme: mase e pluhurizuar, e granular. Densiteti te jete nga 0.6 gr/cm³ deri ne 1.1 gr/cm³. Vlera e ph te jete 9 deri ne 11. Tretshmeria ne uje te jete jo me pak se 95% . Te permbaje lageshti jo me shume se 10%. Permbajtja e lendeve tensioaktive te jete 5% deri 15% dhe =5% per lendet tensioaktive kationike dhe anionike. Aftesia shkumuese te jete me e madhe se 5 cm. Ambalazhimi ne qese plastike ose kuti kartoni sipas kerkesave te autoritetit kontraktor. Te kete emertimin e markes tregetare dhe barkodin e prodhimit te fabrikes.
5. Acid per pastrim: te jete solucion efikas ne heqjen e kriperave te depozituara si dhe papastertive. Zbardhes alkaline me aftesi vepruese dezinfektante. TE permbaje ne masen 12% deri ne 30% acid klorhidrik. Vlera e ph 0-3. Densiteti i acidit te jete 1.0 deri 1.5 gr/cm³. TE jete i tretshem ne uje 100%. Ambalazhimi ne bidona plastike sipas kerkesave te autoritetit kontraktor. Te kete emertimin e markes tregetare dhe barkodin e prodhimit te fabrikes.
6. Solucion lares EC dezinfektues: Ambalazhimi ne shishe plastike me mekanizem per pastrim me te thelle te aneve te EC. Te kete emertimin e markes tregetare dhe barkodin e prodhimit te fabrikes. Vlera e ph te jete jo me e madhe se 13 dhe tretshmeria ne uje te jete 100%. Densiteti te jete 0.9 gr/cm³ deri ne 1.1 gr/cm³. Permbajtja e klorit te jete jo me e madhe se 3.5%.
7. Solucion per pastrimin e smerait/kriperave nga hidrosanitarët : per larje te lavamanit, sanitaret e tualetit, te pastroje ne thellesi kriperat e ujit nga hidrosanitarët. Te parandaloje krijimin e kriperave. Te kete arome parfumi dhe substanca mbrojtese per lekuren e duarve. Gjendja fizike e lengut te jete homogjene. Vlera e PH jo me e madhe se 2.5 dhe jo me e vogel se 1.5. Te jete i tretshem ne uje. Ambalazhimi ne shishe plastike me mekanizem sprucimi dhe sipas kerkesave te autoritetit kontraktor. Te kete emertimin e markes tregetare dhe barkodin e prodhimit te fabrikes.
8. Hipoklorit Natriumi (NaOCl 10-12%): ku permbajtja e klorit aktiv te jete 10-12%. Permbajtja e alkalitetit jo me shume se 5%, te mos kete permbajtje te lendeve te ngurta, te kete ngjyre te verdhe deri ne kafe te alet, me eren karakteristike shpues ne hunde. Ambalazhimi te jete me bidona plastike te pershtatshem qe ti rezistojne efektit shpues te iklorite. Ambalazhimi te jete i etiketuar ku te paraqitet titulli i klorit aktiv. Te jete cilesor.
9. Solucion kundra yndyres: te kete veti te mira pastruese ne te gjitha siperfaqet, te jete ne shishe plastike me mekanizem sprucimi. Gjendja fizike e lengut te jete solucion homogjen, te kete arome parfumi. Vlera e ph te jete 10 deri ne 14. Densiteti te jete 0.9 gr/cm³ deri ne 1.3 gr/cm³. TE kete emertimin e markes tregtare dhe barkodin e prodhimit te fabrikes. Ambalazhimi ne shishe plastike me mekanizem sprucimi dhe sipas kerkesave te autoritetit kontraktor.
10. Solucion per pastrim te parketit: Gjendja fizike te jete solucion homogjen, me arome parfumi. Vlera e PH nga 7 deri ne 10. Densiteti te jete 0.9 gr/cm³ deri ne 1.3 gr/cm³. Te jete i tretshem ne uje 100%. Permbajtja e lendeve tensioaktive te jete me vlere minimale jo me pak se 2.4 % dhe me vlere maksimale jo me shume se 5.5%. Ambalazhimi ne bidona plastike sipas kerkesave te autoritetit kontraktor. Te kete emertimin e markes tregtare dhe barkodin e prodhimit te fabrikes.
- 11 Solucion lares enesh leng: me efekt pastrimi te thelle. Gjendja fizike e lengut te jete solucion homogjen dhe viskoze, te kete arome parfumi. Tretshmeria ne uje te jete 100%. Vlera e PH 6 deri ne 10. Densiteti te varioje nga 0.9 gr/cm³ deri ne 1.2 gr/cm³. Lenda tensioaktive te jete nga 15% deri ne 20%. Ambalazhimi ne shishe plastike sipas

kerkesave te autoritetit kontraktor Te kete emertimin e markes tregetare dhe barkodin e prodhimit te fabrikes.

12. Solucion lares per mobilje: Me efekt pastrimi te njollave te forta dhe pluhurave tek mobiljet. Pastrues neutral me pak shkume. Gjendja fizike e lengut te jete leng homogjen, te kete arome parfumi. Densiteti te jete nga 0.9 gr/cm³ deri ne 1.2 gr/cm³. Vlera e PH te jete nga 6 deri ne 7.5. Permbajtja e lendeve tensioaktive te jete jo me shume se 7%. Ambalazhimi ne shishe plastike sipas kerkesave te autoritetit kontraktor dhe me koke shisheje me mekanizem sprucimi. Te kete emertimin e markes tregetare dhe barkodin e prodhimit te fabrikes.

13. Solucion per zhblllokim lavamani: me efekt zhblllokimi te shpejte, te mos krijoje shkume dhe te mos demtoje tubat plastike. Ambalazhimi ne qese plastike ose kuti kartoni ne trajte pluhuri sipas kerkeses se Autoritetit Kontraktor. Te kete emertimin e markes tregetare dhe barkodin e prodhimit te fabrikes.

14. Solucion zbutes dhe aromatizues rrobash: Te kete emertimin e markes tregetare dhe barkodin e prodhimit te fabrikes. Gjendja fizike te jete solucion homogjen, me arome parfumi. Vlera e PH nga 6.5 deri ne 7.5. Densiteti te jete 0.9 gr/cm³ deri ne 1.3 gr/cm³. TE jete i tretshem ne uje 100%. Ambalazhimi ne shishe plastike sipas kerkesave te autoritetit kontraktor

15. Kapsula per lavastovilje; Gjendja fizike te jete ne forme kapsule ne trajte xheli. Ambalazhimi ne kuti kartoni ose plastike me 20 cope minimumi dhe sipas kerkesave te autoritetit kontraktor

16. Solucion per larjen e sobave. Gjendja fizike ne trajte kremi. Te kete emertimin e markes tregtare dhe barkodin e prodhimit te fabrikes. Ambalazhimi ne shishe plastike 0.5 deri ne 0.75 liter dhe sipas kerkesave te autoritetit kontraktor .

17. Tableta per pastrimin e smerait /kriperave per lavatrice: Te jete ne forme tabletash per perdorim ne lavatrice. Ambalazhimi te jete bere nga fabrika ne kuti kartoni me minimum 20 tableta. Te kete emertimin e markes tregtare dhe barkodin e prodhimit te fabrikes.

18. Aromatik per zyra aerosol: Te jete statik per t'u vendosur lehtesisht ne aparat ne menyre te pavarur. Te jete me arome te kendshme. Ambalazhimi ne forme bombule aerosoli 250 deri ne 300 ml.

19. Aromatik kasetash EC. Me efekt pastrimi dhe dezinfektimi. Te jete aromatizues ne forme sapuni te cilat vendosen brenda ne anen e EC-se.

20. Kripe per lavastovilje. Kripa per lavastovilje zbut ujin ne menyre efektive per te rritur efektin e pastrimit te detergjentit tuaj duke parandaluar formimin e njollave ne enet tuaja. Ambalazhimi te jete ne kuti kartoni trajte pluhuri te granular 1 deri ne 1.5 kg.

26. Sfungjer per larjen e aksesoreve hidrosanitare. Permasat; gjatesia 150 - 10 mm x gjeresia 80 - 10 mm x trashesia 35 ? 5 mm, me material sfungjerik sintetik ku materiali i ashpersuar te jete me trashesi 5-7 mm. Materiali te jete poroz qe nuk lejon zhvillimin e baktereve, dhe te kete jetegjatesi. Paketimi ne qese plastike ose karton me 2-6 cope dhe sipas kerkesave te autoritetit kontraktor.;

28. Doreza gome: te jene rezistente ndaj kimikateve te detergjenteve dhe kimikateve te pastrimit. Te jene per perdorim te larjes se murit e pllakave. Te jene te qendrueshme dhe te pershtatshme ne perdorim dhe te padepertueshme nga lengjet.

38. Leter per fshirjen e duarve e palosur z/v-Fold. Leter higjenike duarsh per perdorim profesional me paketim z/v fold. Te jete e perbere nga celuloze e paster me minimumi 2 shtresa dhe peshe specifike jo me pak se 15g/m². Pakoja te permbaje jo me pak se 200 fije. Gjeresia e

paketimit 10.5 - 0.5 cm. Gjatesia e paketimit 21.5 - 0.5 cm. Paketimi ne pako me jo me pak se 200 fije me plastmas ose karton. Ngjyre e bardhe.

40. Leter higjienike e paketuar rulon: Te jete me paketim min 10 rulon/pako. Te jete e perbere nga celuloze e paster me minimumi 3 shtresa dhe peshe specifike jo me pak se 120 ndarje. Te jete cilesore dhe e bute. Te jete e tretshme ne uje.

42. Qese mbeturinash 30-40 liter per koshat, me permasa 35 ? 5cm x 35? 5cm, 30-40 litra, trashesia 20-30 micron, te jete e paketuar ne 10 fije.

43. Qese mbeturinash 40-50 liter per koshat, me permasa 50 ? 5cm x 60? 5cm, 40-50 litra, trashesia 20-30 micron, te jete e paketuar ne ne 10 fije.

44. Qese mbeturinash 70-80 liter per koshat, me permasa 60 ? 10cm x 80 ? 10cm, 70-80 litra, trashesia 20-30 micron, te jete e paketuar ne ne 10 fije.

45. Qese mbeturinash 100-120 liter per koshat, me permasa 80 ? 10cm x 100? 10cm, volumi 100-120 litra, trashesia 30-40 micron, te jete e paketuar ne ne 10 fije.

Sic deklarua edhe me siper, shoqeria "Euro MEGA 2010" SHPK, ka mbi 15 vjet qe eshte ne treg dhe njeh shume mire produktet e materialeve te pastrimit dhe te detergjenteve qe prodhohen dhe tregtohen ne vend, njeh shume mire edhe konkurentet e saj.

Ofertuesi "Anbim" SHPK, nder te tjera ka dorezuar mostra per detergjentet me mbishkrimin "Epta", produkte per te cilat shoqeria "Anbim" SHPK, deklaroi se eshte prodhuese e tyre edhe pse kjo shoqeri i prodhon ato ne kundërshtim me legjislacionin e fushes se detergjenteve pasi prodhimi i detergjenteve rregullohet me ligj dhe shoqerite te cilat prodhojne detergjentet referuar legjislacionit shqiptar ne fuqi duhet te jene te pajisur me leje mjedisore kategoria per ndikim ne mjedis, leje te cilat kjo shoqeri nuk i disponon, mjafton te besh verifikimet ne regjistrat respective ne faqen Eeb te Qendres Kombetare te Licensimit.

Ne kushtet kur kjo shoqeri nuk i respekton legjislacionin ne fuqi ne lidhje me kushtet qe duhet te plotesojne shoqerite qe prodhojne produkte detergjente ne besojme se edhe produktet detergjente, te prodhuara nga kjo shoqeri nuk i plotesojne te gjitha kerkesat per tu vendosur ne treg si dhe qe jane kerkuar ng AK-ja ne shtojcen 6 te specifikimeve teknike.

Se pari: Konkretisht ne besojme se, per produktet detergjente me numra rendore si me poshte:

1. Solucion lares dysHEMEJE (pLLakash)
2. Detergjent lares xhamash
3. Sapun i lengshem per duart
4. Pluhur per larjen e rrobave (Whites and colors)
5. Acid per pastrim
6. Solucion lares WC dezinfektues
7. Solucion per pastrimin e smercit/kriprave nga hidrosanitaret me mekanizem sprucimi
9. Solucion kundra yndyres (sgrasatore)
10. Solucion per pastrim te parketit
11. Solucion lares enesh leng

12. Solucion lares per mobilje

13. Solucion per zhblllokim lavamani

14. Solucion zbutës dhe aromatizues rrobash

16. Solucion per larjen e sobave

17. Tableta per pastrimin e smercit /kriperave per lavatrice,

Mostrat e dorezuara nga ofertuesi “Anbim” SHPK nuk kanë të pasqyrura në ambalazhin e tyre barkodin e prodhimit të fabrikës, në kundërshtim të hapur me kërkesën e AK-se të percaktuar shprehimisht për këto produkte në shtojcën 6 të DT-se.

Se dyti:

Pretendojme se, mostra e dorezuar për produktin me numër rendor 8 (Hipoklorit Natriumi (naocl 10-12%)) nuk e ka përmbajtjen e klorit aktiv 10-12%, sic është kërkuar nga AK-ja për këtë produkt

Në shtojcën 6 të DT-se.

Në pikën 6/a) të Nenit 40 (kërkesa të vecanta për kontratat e mallrave) të vkm 285/2021 e ndryshuar percaktohet se:

“...6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’i kërkojë operatoreve ekonomike të dorezojnë deshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të percaktuara në dokumentet e tenderit, si:

A) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rendesi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor percakton qartë procedurën për dorezimin e mostrave, duke garantuar aksesin e cdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuader, me kusht që kontrata të fjalë ose marrëveshja kuader të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;

Dhe/ose...e

Sa më sipër qellimi i kerkimit të mostrave është verifikimi nëse produktet e ofruara i plotësojnë ose jo kërkesat e percaktura nga AK-ja në shtojcën e specifikimeve teknike.

Në jemi të bindur që për mostrat e cituara më sipër ofertuesi Anbim SHPK nuk i plotëson kërkesat e percaktuara për këto produkte në shtojcën 6 të dt-se. [...].

Për gjithë sa më sipër argumentuam kërkojme skualifikimin e ofertës së paraqitur nga ofertuesi “Anbim” SHPK pasi mostrat e dorezuara për artikujt e cituar më sipër nuk i plotësojnë kërkesat e specifikimeve teknike të percaktura për këto produkte në shtojcën 6 të DT-se.”

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 2497/1 prot, datë 16.09.2025 me kriteret që operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Anbim” SHPK, të parashtruara në ankesën me nr. 2497 prot, datë 16.09.2025.

II.6. Me shkresën nr. 8192/1 prot, datë 23.09.2025, me objekt “Shkresë përcjellëse”, protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 2497/2 prot., datë 26.09.2025 autoriteti kontraktor Bashkia Kamëz ka dërguar vendimin e KSHA-së nr. 8192 prot., datë 23.09.2025, lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Euro Mega 2010” SHPK. Referuar Vendimit të KSHA-së rezulton se pretendimet e ankimuesit janë refuzuar nga ky komision, duke argumentuar si vijon:

“[...] Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave verifikoi në sistemin e prokurimit elektronik, ku ndër të tjera Operatori ekonomik ankimues “EURO MEGA 2010” SHPK pretendon: “Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Anbim” SHPK”.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi u njoh dhe shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ankimues, shqyrtoi Dokumentat Standarte të Tenderit dhe formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik “Anbim” SHPK, dhe konstatoi se oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Anbim” SHPK është në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara në dokumentet standarte të tenderit.

Në pikën 2, të nenit, të Vendimit nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar përcaktohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. devijim material, reserve ose inospranim, sic përcaktohet më poshtë. i. “devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit; ii. “rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe iii. “mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit”.

Referuar dispozitës ligjore të sipërcituar dhe legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti **Kontraktor do të konsiderojë** një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo **është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.**

Për pasojë, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon, se operatori ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, konkretisht Operatori ekonomik “Anbim” SHPK, plotëson kërkesat e vendosura në dokumentet Standarte të Tenderit.

Sa më sipër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, mbështetur në nenin 102 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, vendosi mospranimin e ankesës së paraqitur nga Operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK.”.

II.7. Me qëllim shqyrtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues, me anë të shkresës nr. 2497/3 prot., datë 17.10.2025, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor që të dërgojë pranë KPP-së mostrat e dorëzuara nga operatorët ekonomikë “Anbim” SHPK, “Euro Mega 2010” SHPK dhe “Besim Kamberi” PF pranë autoritetit kontraktor së bashku me dokumentacionin shoqërues të tyre.

II.8. Me shkresën nr. 9134/1 prot, datës 22.10.2025, me objekt “Dërgim Mostra”, protokolluar me tonën me nr. 2497/4 prot., datë 22.10.2025, autoriteti kontraktor ka depozituar informacion, dokumentacion dhe mostrat e operatorëve ekonomikë “Anbim” SHPK, “Euro Mega 2010” SHPK dhe “Besim Kamberi” PF sipas kërkesës nr. 2497/3 prot, datë 17.10.2025 të Komisionit Prokurimit Publik.

II.9. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike, rezulton se në datën 08.09.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit përfundimtar të ofertave si vijon:

1. “Anbim” SHPK	7.870.911	lekë	kualifikuar
2. “Besim Kamberi” PF	7.993.803	lekë	skualifikuar
3. “Euro Mega 2010” SHPK	7.999.000	lekë	kualifikuar
4. “Malvina Visoka” PF	8.418.280	lekë	kualifikuar
5. “Leon Group” SHPK	9.209.548,17	lekë	kualifikuar
6. “Atlantik 3” SHPK	10.999.445	lekë	kualifikuar

II.10. Në datën 09.09.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE njoftimin e fituesit të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.11. Në datën 15.09.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5807 dhe nr. 2498/2025 protokoli, datë 16.09.2025 e operatorit ekonomik “Malvina Visoka” PF, për procedurën e prokurimit *Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-51165-06-13-2025 me objekt

“Blerje mjete pastrimi” me fond limit 12,583,334 (dymbëdhjetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e katër) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 22.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Anbim” SHPK dhe operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK, si dhe lënien të skualifikuar dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit për operatorin ekonomik “Besim Kamberi” PF në procedurën e mësipërme të prokurimit, me argumentat si vijon:

“Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

I. Kundershtojme kualifikimin e ofertave të shoqerive “Euro Mega” shpk dhe “Anbim” shpk si dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit për operatorin ekonomik “Besim Kamberi” shpk të bërë nga KVO-ja, si me poshte vijon: Autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit konkretisht në kriterin 2.3.5 ka kërkuar:

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostrat (kampionet) ditën e hapjes së ofertave, nga jo më pak se 1 (një) kampion për mallrat objekt prokurimi, për artikujt e kërkuar në shtojcën 7, përkatësisht me nr.rendor 1 deri në 20, 26, 28, 38, 40, 42, 43, 44, 45.

Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik.

- Mostra duhet të jetë për të gjithë artikujt e kërkuar, objekt i këtij prokurimi.*
- Mostrat duhet të jenë të njëjta me ato të ofruara nga operatori ekonomik ofertues në dokumentacionin teknik të paraqitur në sistemin e publikimeve elektronike (SPE).*

Në shtojcën 5 specifikimet teknike autoriteti kontraktor ka parashikuar mallrat objekt prokurimi se bashku me specifikimet teknike të secilit produkt:

1. Solucion për larjen e dyshemesë. *Të jetë i përshtatshëm për vende higjienike, dhoma zhveshje, palestra dhe kudo ku ka probleme arome të pakëndshme. Të jetë me veti të mira pastruese dhe aromatizuese. Gjendja fizike: të jetë solucion lëng, me aromë parfumi. Vlera e PH të jetë 5 deri në 10. Paraqitja fizike e solucionit të jetë homogjene. Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³-1.1 gr/cm³. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë jo më shumë se 10%. Ambalazhimi në shishe plastike. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.*

2. Detergjent për larje xhamash. *Të jetë me efekt pastrimi dhe shkëlqim të xhamave. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjen, të ketë aromë parfumi. Vlera e PH 5 deri në 11. Përbërja të jetë homogjene dhe të ketë densitet 0.9 gr/cm³ deri në 1.2 gr/cm³. Lënda tensioaktive të variojë nga 1.0% deri në 4.0%. Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizëm sprucimi .Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.*

3. Sapun i lëngshëm për duart. *Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion viskoz dhe homogjen. Të mos jetë irritues me lëkurën e duarve. Vlera e PH jo më vogël se 5.5 dhe jo më e madhe se 8. Densiteti i lëngut të jetë 0.9 deri në 1.1 gr/cm³. Aromë parfumi. Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Lëndët tensioaktive të jenë nga 5% deri në 11%. Ambalazhimi nga fabrika në shishe plastike me mekanizëm në pjesën e trupit të shishes për manovrim të produktit gjatë përdorimit*

dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.

4. Pluhur larës për rroba: të ketë aftësi vepruese dhe pastruese të larta. Pamja e jashtme: masë e pluhurizuar, e granular. Densiteti të jetë nga 0.6 gr/cm³ deri në 1.1 gr/cm³. Vlera e pH të jetë 9 deri në 11. Tretshmëria në ujë të jetë jo më pak se 95% . Të përmbajë lagështi jo më shumë se 10%. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë 5% deri 15% dhe ≤5% për lëndët tensioaktive kationike dhe anionike. Aftësia shkumuese të jetë më e madhe se 5 cm. Ambalazhimi në qese plastike ose kuti kartoni sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.

5. Acid për pastrim: të jetë solucion efikas në heqjen e kripërave të depozituara si dhe papastërtive. Zbardhës alkaline me aftësi vepruese dezinfektante. Të përmbajë në masën 12% deri në 30% acid klorhidrik. Vlera e pH 0-3. Densiteti i acidit të jetë 1.0 deri 1.5 gr/cm³. Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Ambalazhimi në bidona plastike sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.

6. Solucion larës WC dezinfektues: Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizëm për pastrim më të thellë të anëve të ËC. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Vlera e pH të jetë jo më e madhe se 13 dhe tretshmëria në ujë të jetë 100%. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ deri në 1.1 gr/cm³. Përmbajtja e klorit të jetë jo më e madhe se 3.5%.

7. Solucion për pastrimin e smërçit/kripërave nga hidrosanitarët : për larje të lavamanit, sanitaret e tualetit, të pastrojë në thellësi kripërat e ujit nga hidrosanitarët. Të parandalojë krijimin e kripërave. Të ketë aromë parfumi dhe substanca mbrojtëse për lëkurën e duarve. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjene. Vlera e PH jo më e madhe se 2.5 dhe jo më e vogël se 1.5. Të jetë i tretshëm në ujë. Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizëm sprucimi dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.

8. Hipoklorit Natriumi (NaOCl 10-12%): ku përmbajtja e klorit aktiv të jetë 10-12%. Përmbajtja e alkalitetit jo më shumë se 5%, të mos ketë përmbajtje të lëndëve të ngurta, të ketë ngjyrë të verdhë deri në kafe të çelët, me erën karakteristike shpues në hundë. Ambalazhimi të jetë me bidona plastike të përshtatshëm që ti rezistojnë efektit shpues të “klorit”. Ambalazhimi të jetë i etiketuar ku të paraqitet titulli i klorit aktiv. Të jetë cilësor.

9. Solucion kundër yndyrës: të ketë veti të mira pastruese në të gjitha sipërfaqet, të jetë në shishe plastike me mekanizëm sprucimi. Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion homogjen, të ketë aromë parfumi. Vlera e pH të jetë 10 deri në 14. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ deri në 1.3 gr/cm³. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizëm sprucimi dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

10. Solucion për pastrim të parketit: Gjendja fizike të jetë solucion homogjen, me arome parfumi. Vlera e PH nga 7 deri në 10. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ deri në 1.3 gr/cm³. Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë me vlerë minimale jo më pak se 2.4 % dhe me vlerë maksimale jo më shumë se 5.5%. Ambalazhimi në bidona plastike sipas

kërkesave të autoritetit kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.

11. Solucion larës enësh lëng: me efekt pastrimi të thellë. Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion homogjen dhe viskoze, të ketë aromë parfumi. Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Vlera e PH 6 deri në 10. Densiteti të variojë nga 0.9 gr/cm³ deri në 1.2 gr/cm³. Lënda tensioaktive të jetë nga 15% deri në 20%. Ambalazhimi në shishe plastike sipas kërkesave të autoritetit kontraktor Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.

12. Solucion larës për mobilje: Me efekt pastrimi të njollave të forta dhe pluhurave tek mobiljet. Pastrues neutral me pak shkumë. Gjendja fizike e lëngut të jetë lëng homogjen, të ketë aromë parfumi. Densiteti të jetë nga 0.9 gr/cm³ deri në 1.2 gr/cm³. Vlera e PH të jetë nga 6 deri në 7.5. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë jo më shumë se 7%. Ambalazhimi në shishe plastike sipas kërkesave të autoritetit kontraktor dhe me kokë shisheje me mekanizëm sprucimi. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.

14. Solucion zbutës dhe aromatizues rrobash: Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike të jetë solucion homogjen, me aromë parfumi. Vlera e PH nga 6.5 deri në 7.5. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ deri në 1.3 gr/cm³. Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Ambalazhimi në shishe plastike sipas kërkesave të autoritetit kontraktor

38. Letër për fshirjen e duarve e palosur z/v-Fold. Letër higjienike duarsh për përdorim profesional me paketim z/v fold. Të jetë e përbërë nga celulozë e pastër me minimumi 2 shtresa dhe peshë specifike jo më pak se 15g/m². Pakoja të përmbajë jo më pak se 200 fije. Gjerësia e paketimit 10.5 ± 0.5 cm. Gjatësia e paketimit 21.5 ± 0.5 cm. Paketimi në pako me jo më pak se 200 fije me plastmas ose karton. Ngjyrë e bardhë.

40. Letër higjienike e paketuar rulon: Të jetë me paketim min 10 rulon/pako. Të jetë e përbërë nga celulozë e pastër me minimumi 3 shtresa dhe peshë specifike jo më pak se 120 ndarje. Të jetë cilësore dhe e butë. Të jetë e tretshme në ujë.

42. Qese mbeturinash 30-40 liter për koshat, me përmasa 35 ± 5cm x 35± 5cm, 30-40 litra, trashësia 20-30 micron, të jetë e paketuar në 10 fije.

43. Qese mbeturinash 40-50 liter për koshat, me përmasa 50 ± 5cm x 60± 5cm, 40-50 litra, trashësia 20-30 micron, të jetë e paketuar në 10 fije.

44. Qese mbeturinash 70-80 liter për koshat, me përmasa 60 ± 10cm x 80 ± 10cm, 70-80 litra, trashësia 20-30 micron, të jetë e paketuar në 10 fije.

45. Qese mbeturinash 100-120 liter për koshat, me përmasa 80 ± 10cm x 100± 10cm, volumi 100-120 litra, trashësia 30-40 micron, të jetë e paketuar në 10 fije.

Duke qene se jemi nje kompani e vjeter ne treg persa i perket kesaj fushe veprimtarie, dhe pjesemarres ne procedura prokurimi prej vitesh kemi arritur ti njohim mire jo vetem kapacitetet e konkurenteve tane por edhe prodhuesit se ku ata furnizohen, duke patur keto njohuri ne kemi bindjen qe kriteri ne lidhje me mostrat per produktet e sipercituara nuk permbushet nga OE Euro Mega 2010 shpk, Anbim shpk dhe Besim Kamberi shpk, ne lidhje me kriterin 2.3.5 te DST autoriteti kontraktor ka kerkuar qellimi i paraqitjes se mostrave eshte qe

autoriteti kontraktor te bindet qe produktet e ofertuara nga ana e operatoreve ekonomike te jene ne perputhje me specifikimet teknike te percaktuara nga ana e AK ne DST, pasi eshte e vetmja menyre verifikimi duke qene se pas ankesave te bera per kete procedure prane KPP nga kjo e fundit eshte vendosur te hiqen kriteret si MSDS e produkteve apo kataloget e produkteve, atehere e vetmja mundesi e autoritetit kontraktor per te verifikuar nese specifikimet teknike te kerkuara do te plotesohen ishte kerkesa per paraqitjen e mostrave aq me teper qe pjesa me e madhe e produkteve jane me perberes kimikat, si produktet e renditura me siper nga numri rendor 1 deri ne 14, pra keto mostra duhet te kishin ne ambalazhin e tyre permbajtjen e specifikimeve teknike te kerkuara nga ana e autoriteti, pikerisht per kete fakt ne kemi dyshimet tona se mostrat e paraqitura per keto produkte nga keta operator ekonomik pra Euro Mega 2010 shpk, Anbim shpk si dhe Besim Kamberi shpk nuk kane ne etiketen e ambalazhit te produktit te pasqyruar asnje specifikim teknik te percaktuar nga ana e AK ne shtojcen 6, per kete arsye kerkojme nga ane KSHA dhe KPP te behet nje verifikim i ketyre mostrave, nese permbajne specifikimet teknike te kerkuara nga AK. Gjithashtu nga eksperiencia jone ne kete fushe kemi dyshimet dhe bindje se mostrat e dorezuara nga ana e ketyre operatoreve per artikujt nga nr.1 deri ne nr.14 nuk jane produkte reale te nje prodhuesi te vertet pse e themi kete dhe kjo eshte lehtesisht e verifikueshme, AK per keto produkte ne specifikimet teknike ka kerkuar nder te tjera qe te kete emertimin e markes tregtare dhe barkodin e prodhimit te fabrikes, ky percaktim nga ana e AK nuk eshte bere me kot, po me nje qellim te caktuar si garanci per AK qe keto produkte do te jene te prodhuara nga nje prodhues real dhe serioz. AK si rrjedhoje e ankesave prane KPP eshte detyruar te heq disa kriteret kualifikuese si autorizimi i prodhuesit, MSDS e artikujve, apo dhe kataloget, kriteret keto te cilat per AK ishin mjaft te rendesishme dhe garanci qe produktet do te ishin ne perputhje me specifikimet teknike. Pyetja qe lind ne keto kushte kur keto kriteret jane hequr, eshte sesi AK do te sigurohet qe mostrat e paraqitura dhe malli qe do te marre ne dorezim do te jete sipas specifikimeve teknike, e vetmja garanci qe AK ka ne keto momente eshte qe secili prej ketyre produkteve te kete ne etiketen e ambalazhit te specifikuar pervec emrit te produktit edhe specifikimet teknike, apo akoma me tej sikurse eshte kerkuar nga AK edhe barkodin e prodhuesit me qellim qe ne momentin qe do te skanohet barkodi automatisht skanimi te direkton ne faqen e prodhuesit kur ti mund te verifikosh se pari qe ky produkt eshte i prodhuar nga nje prodhues real dhe i vertet, ne kemi bindjen dhe dyshimin se nese do te beni nje prove duke skanuar barkodet e ketyre artikujve nese kane sepse pjesa me e madhe e tyre nuk kane barkod per tu skanuar por edhe ne se kane do te konstatoje se nuk ju adresojne askund pra nuk shfaqin se kush eshte prodhuesi real ne menyre qe te behet lidhja me marken tregtare te produktit. Pasi edhe qellimi i ligjvenesit ne nenin 40 pika 6 e VKM 285 eshte qe mostra e mallit, kerkohet kur AK e gjykon se kjo ka rendesi per vleresimin e ofertes teknike, dhe ne kete rast kur kriteret si autorizim prodhuesi, MSDS apo katalog produkti jane hequr, mostra mbetet e vetmja mundesi per te vetetuar permbushjen e specifikimeve teknike.

[...]. Kerkojme qe te behet nje verifikim nese per artikujt mostra te sipercituara, a arrihet te behet verifikimi perberjes se artikullit me specifikimet teknike. Atehere persa kohe qe ligjvenesit ka percaktuar se eshte detyrim ligjor i subjektit ofertues te provoje me dokumentacion te plote dhe ne perputhje me kerkesat e autoritetit kontraktor, plotesimin e kriterëve te kerkuara ne dokumentet e tenderit, pasi ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto dokumente duhet te

refuzohen si te papranueshme. Pikerisht ne kemi dyshime dhe bindje se operatoret ekonomik Euro Mega 2010 shpk, Anbim shpk, dhe Besim Kamberi PF, ne rastin konkret mostra e paraqitur prej tyre duhej te permbanin te dhena te plota mbi perberjen e artikullit ne permbushje te specifikimeve teknike. Pasi qellimi i AK per paraqitje te mostrave eshte nese ato permbushin specifikimet teknike ne perputhje me nenin 77 te ligjit 162/2020 “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar. Sepse vetem mbi bazen e permbushjes se specifikimeve teknike garantohet permbushja e cilesise se kerkuar. [...]

Gjithashtu kemi dyshimet tona se operatori Euro Mega 2010 shpk, Anbim shpk dhe Besim Kamberi PF, nuk ka dorezuar mostrat e duhura per produktet e kerkuara nga ana e autoritetit kontraktor konkretisht 42, 43, 44, 45, te cilat jane produkte qese plastike te kapaciteteve te ndryshme mbajtese, si dhe me permasa te ndryshme, ne asnje prej mostrava te ketyre 4 produkteve te cituara te dorezuara nga keta operatore nuk evidentohet asnje specifik teknike, ne nuk arrijme te kuptojme se ku e gjen guximin KVO e AK qe ka pranuar si te rregullta keto mostra. Prandaj kerkojme ti kerkohet informacion AK dhe mostrat e dorezuara nga keta OE, ne menyre qe te konstatoji ju si KPP qe keto mostra nuk kane asnje te dhene nga ato te kerkuara nga AK as ne kuptim te permasave as te sasise mbajtese, pasi mostrat e dorzuara prej tyre dyshojme qe ne paketim nuk permbajne numrin e fijeve sipas etiketes, prandaj kerkojme nga KPP si institucion me i larte ne fushen e prokurimit publik te marre parasysh kete informacion dhe te merren masat e nevojshme per verifikimin e mostrave me specifikimet teknike te percaktuara nga ana e AK ne DST, pasi ne bindjen tone keto operator nuk kane derguar ditene e hapjes se ofertave mostrat e kerkuara nga autoriteti kontraktor, pasi mostrat e dorzuara nuk kane lidhje fare me produktet qese plasmasi te kerkuara nga AK.

Gjithashtu kerkojme qe te behet verifikim i mostres me nr rendor 38 te dorezuar nga ana e operatorit ekonomik Euro Mega 2010 shpk, nese produkti moster i dorezuar nga ky operator ka lidhje me produktin nr 38 te kerkuar nga AK, pasi kemi dyshime se ky OE nuk ka dorezuar jo vetem mostren e duhur pra ne vend qe te dorzonte Leter per fshirjen e duarve e palosur z/v-Fold, per kete produkt ka dorezuar si moster produkt ne forme tjeter por dhe specifikimet e kerkuara nga AK nuk jane ne perputhje me produktin e dorezuar nga ky OE per kete produkt.

Bazuar ne ligjin e prokurimit publik, kerkojme nga KPP qe si institucion me i larte ne fushen e prokurimit publik te marre parasysh kete informacion dhe te merren masat e nevojshme per verifikimin e mostrave, nese ato jane ne perputhje me permbajtjen e kriterit 2.3.5 dhe me specifikimet teknike te kerkuara nga AK, qendrim ky tashme i mbajtur nga KPP ne vendimarrjen e saj si ne rastin e vendimit 370/2023; vendimit 1029/2025; dhe vendimit 1212/2025.

II. Kundershtojme kualifikimin e ofertave te shoqerive “Euro Mega” shpk dhe “Anbim” shpk si dhe shtimin e arsyeve te skualifikimit per operatorin ekonomik “Besim Kamberi” pf te bere nga KVO-ja, si me poshte vijon:

Autoriteti kontraktor ne dokumentat standarte te tenderit konkretisht ne kriterin 2.3.4 ka kerkuar 2.3.4. Operatori ekonomik ofertues per produktet objekt prokurimi me nr.1, 2, 3 ne tabelen e shtojces 7, duhet te paraqese dokumentin me te dhenat e sigurise (MSDS) te leshuara/publikuara nga prodhuesi/it dhe Certifikaten e Konformitetit CE (kur eshte e aplikueshme).

Duke qene se jemi nje kompani e vjeter ne treg persa i perket kesaj fushe te veprimtarise dhe pjesemarres ne procedura prokurimi prej vitesh kemi arritur ti njohim mire jo vetem kapacitetet e konkurrenteve tane por edhe prodhuesit se nga ata furnizohen ndaj duke patur keto njohuri dhe duke ditur se per disa nga produktet e sipercituara konkretisht artikullin me nr rendor 1, 2, 3, duke qene se asnje nga keta 3 operatore ekonomik nuk eshte prodhues i ketyre tre produkteve, atehere kemi dyshime se keta OE nuk kane paraqitur MSDS e prodhuesit dhe Certifikaten e Konformitetit CE pasi referuar legjislacionit specifik per keto tre produkte eshte e detyrueshme dhe e aplikueshme Certifikata e Konformitetit CE, pasi eshte e veshtire qe te gjenden prodhues qe te leshojne MSDS dhe Certifikata e Konformitetit CE per keto artikuj, ndaj kerkojme nga ana juaj qe te beni nje verifikim ketyre MSDS per keto tre artikuj prane prodhuesve te deklaruar nga keta operator ekonomik ne kete procedure prokurimi nese jane leshuar vertet MSDS nga keta prodhues apo jo, pasi kemi dyshimet tona se keto OE nuk e permbushin kete kriter pasi MSDS dhe Certifikatate Konformitetit CE nuk jane te leshuara nga prodhuesit e deklaruar. Per sa thame me lart, kerkojme skualifikimin e OE Euro Mega 2010 shpk dhe Anbim shpk, si dhe lenien te skualifikuar per arsyet e shpallura nga KVO dhe shtimin e arsyeve te skualifikimit per operatorin ekonomik Besim Kamberi shpk ne kete procedure prokurimi. ”

II.12. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 2498/1 prot, datë 16.09.2025 kriteret që operatori ekonomik “Malvina Visoka” PF pretendon se nuk përmbushen nga operatorët ekonomikë “Anbim” SHPK, “Euro Mega 2010” SHPK dhe “Besim Kamberi” PF, të parashtruara në ankesën me nr.2498 prot, datë 16.09.2025.

II.13. Me shkresën nr. 8191/1 prot, datë 23.09.2025, me objekt “Shkresë përcjellëse”, protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 2498/2 prot., datë 26.09.2025 autoriteti kontraktor Bashkia Kamëz ka dërguar vendimin e KSHA-së nr. 8191 prot., datë 23.09.2025, lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Malvina Visoka” PF. Referuar Vendimit të KSHA-së rezulton se pretendimet e ankimuesit janë refuzuar nga ky komision, duke argumentuar si vijon:

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave verifikoi në sistemin e prokurimit elektronik, ku ndër të tjera Operatori ekonomik ankimues “Malvina Visoka” PF pretendon: “Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Anbim” SHPK, “Euro Mega 2010” SHPK. Gjithashtu pretendohet të mbetet i skualifikuar operatori ekonomik “Besim Kamberi” PF.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi u njoh dhe shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ankimues, shqyrtoi Dokumentat Standarte të Tenderit dhe formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik “Anbim” SHPK, dhe konstatoi se oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Anbim” SHPK është në përputhje

të plotë me kërkesat e përcaktuara në dokumentet standarte të tenderit.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi u njoh dhe shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ankimues, shqyrtoi Dokumentat Standarte të Tenderit dhe formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentacionin e ngarkuar në sistem nga operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK, dhe konstatoi se oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK është në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara në dokumentet standarte të tenderit.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi u njoh dhe shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ankimues, shqyrtoi Dokumentat Standarte të Tenderit dhe formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentacionin e ngarkuar në sistem nga operatori ekonomik “Besim Kamberi” PF, dhe konstatoi se qëndrojnë arsyet e skualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Besim Kamberi” PF, pasi oferta përmbanë mangësitë e konstatuara nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave. [...]

Në pikën 2, të nenit, të Vendimit nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar përcaktohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. devijim material, reserve ose inospranim, sic përcaktohet më poshtë. i. “devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit; ii. “rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe iii. “mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit”.

Referuar dispozitës ligjore të sipërcituar dhe legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti Kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Sa më sipër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, mbështetur në nenin 102 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, vendosi mospranimin e ankesës së paraqitur nga Operatori ekonomik “Malvina Visoka” PF.

II.14. Në datën 16.10.2025 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 2498/3 prot., shkresa me argumenta shtesë e operatorit ekonomik ankimues “Malvina Visoka” PF.

II.15. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor u konstatua se, nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020, për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Malvina Visoka” PF se: “I. *Kundershtojme kualifikimin e ofertave te shoqerive “Euro Mega” shpk dhe “Anbim” shpk si dhe shtimin e arsyeve te skualifikimit per operatorin ekonomik “Besim Kamberi” shpk te bere nga KVO-ja, si me poshte vijon: Autoriteti kontraktor ne dokumentat standarte te tenderit konkretisht ne kriterin 2.3.5 ka kerkuar: 2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostrat (kampionet) ditën e hapjes së ofertave, nga jo më pak se 1 (një) kampion për mallrat objekt prokurimi, për artikujt e kërkuar në shtojcen 7, përkatësisht me nr.rendor 1 deri në 20, 26, 28, 38, 40, 42, 43, 44, 45. Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik. Mostra duhet të jetë për të gjithë artikujt e kërkuar, objekt i këtij prokurimi. Mostrat duhet të jenë të njëjta me ato të ofruara nga operatori ekonomik ofertues në dokumentacionin teknik të paraqitur në sistemin e publikimeve elektronike (SPE). Ne shtojcen 5 specifikimet teknike autoriteti kontraktor ka parashikuar mallrat objekt prokurimi se bashku me specifikimet teknike te secilit produkt: **1. Solucion për larjen e dyshemesë.** Të jetë i përshtatshëm për vende higjienike, dhoma zhveshje, palestra dhe kudo ku ka probleme arome të pakëndshme. Të jetë me veti të mira pastruese dhe aromatizuese. Gjendja fizike: të jetë solucion lëng, me aromë parfumi. Vlera e PH të jetë 5 deri në 10. Paraqitja fizike e solucionit të jetë homogjene. Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³-1.1 gr/cm³. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë jo më shumë se 10%. Ambalazhimi në shishe plastike. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. **2. Detergjent për larje xhamash.** Të jetë me efekt pastrimi dhe shkëlqim të xhamave. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjen, të ketë aromë parfumi. Vlera e PH 5 deri në 11. Përbërja të jetë homogjene dhe të ketë densitet 0.9 gr/cm³ deri në 1.2 gr/cm³. Lënda tensioaktive të variojë nga 1.0% deri në 4.0%. Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizëm sprucimi .Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. **3. Sapun i lëngshëm për duart.** Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion viskoz dhe homogjen. Të mos jetë irritues me lëkurën e duarve. Vlera e PH jo më vogël se 5.5 dhe jo më e madhe se 8. Densiteti i lëngut të jetë 0.9 deri në 1.1 gr/cm³. Aromë parfumi. Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Lëndët tensioaktive të jenë nga 5% deri në 11%. Ambalazhimi nga fabrika në shishe plastike me mekanizëm në pjesën e trupit të shishes për manovrim të produktit gjatë përdorimit dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. **4. Pluhur larës për rroba:** të ketë aftësi vepruese dhe pastruese të larta.*

Pamja e jashtme: masë e pluhurizuar, e granular. Densiteti të jetë nga 0.6 gr/cm³ deri në 1.1 gr/cm³. Vlera e pH të jetë 9 deri në 11. Tretshmëria në ujë të jetë jo më pak se 95% . Të përmbajë lagështi jo më shumë se 10%. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë 5% deri 15% dhe ≤5% për lëndët tensioaktive kationike dhe anionike. Aftësia shkumuese të jetë më e madhe se 5 cm. Ambalazhimi në qese plastike ose kuti kartoni sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.

5. Acid për pastrim: të jetë solucion efikas në heqjen e kripërave të depozituara si dhe papastërtive. Zbardhës alkaline me aftësi vepruese dezinfektante. Të përmbajë në masën 12% deri në 30% acid klorhidrik. Vlera e pH 0-3. Densiteti i acidit të jetë 1.0 deri 1.5 gr/cm³. Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Ambalazhimi në bidona plastikë sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.

6. Solucion larës ËC dezinfektues: Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizëm për pastrim më të thellë të anëve të ËC. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Vlera e pH të jetë jo më e madhe se 13 dhe tretshmëria në ujë të jetë 100%. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ deri në 1.1 gr/cm³. Përmbajtja e klorit të jetë jo më e madhe se 3.5%.

7. Solucion për pastrimin e smërçit/kripërave nga hidrosanitarët : për larje të lavamanit, sanitaret e tualetit, të pastrojë në thellësi kripërat e ujit nga hidrosanitarët. Të parandalojë krijimin e kripërave. Të ketë aromë parfumi dhe substanca mbrojtëse për lëkurën e duarve. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjene. Vlera e PH jo më e madhe se 2.5 dhe jo më e vogël se 1.5. Të jetë i tretshëm në ujë. Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizëm sprucimi dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.

8. Hipoklorit Natriumi (NaOCl 10-12%): ku përmbajtja e klorit aktiv të jetë 10-12%. Përmbajtja e alkalitetit jo më shumë se 5%, të mos ketë përmbajtje të lëndëve të ngurta, të ketë ngjyrë të verdhë deri në kafe të çelët, me erën karakteristike shpues në hundë. Ambalazhimi të jetë me bidona plastikë të përshtatshëm që ti rezistojnë efektit shpues të “klorit”. Ambalazhimi të jetë i etiketuar ku të paraqitet titulli i klorit aktiv. Të jetë cilësor.

9. Solucion kundra yndyrës: të ketë veti të mira pastruese në të gjitha sipërfaqet, të jetë në shishe plastike me mekanizëm sprucimi. Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion homogjen, të ketë aromë parfumi. Vlera e pH të jetë 10 deri në 14. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ deri në 1.3 gr/cm³. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Ambalazhimi në shishe plastikë me mekanizëm sprucimi dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

10. Solucion për pastrim të parketit: Gjendja fizike të jetë solucion homogjen, me arome parfumi. Vlera e PH nga 7 deri në 10. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ deri në 1.3 gr/cm³. Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë me vlerë minimale jo më pak se 2.4 % dhe me vlerë maksimale jo më shumë se 5.5%. Ambalazhimi në bidona plastikë sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.

11. Solucion larës enësh lëng: me efekt pastrimi të thellë. Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion homogjen dhe viskoze, të ketë aromë parfumi. Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Vlera e PH 6 deri në 10. Densiteti të variojë nga 0.9 gr/cm³ deri në 1.2 gr/cm³. Lënda tensioaktive të jetë nga 15% deri në 20%. Ambalazhimi në shishe plastikë sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.

12. Solucion larës për mobilje: Me efekt pastrimi të njollave të forta dhe pluhurave tek mobiljet. Pastrues neutral me pak shkumë. Gjendja fizike e lëngut të jetë lëng homogjen, të ketë aromë parfumi. Densiteti të jetë nga 0.9 gr/cm³ deri në 1.2 gr/cm³. Vlera e PH të jetë nga 6 deri në 7.5. Përmbajtja e

lëndëve tensioaktive të jetë jo më shumë se 7%. Ambalazhimi në shishe plastike sipas kërkesave të autoritetit kontraktor dhe me kokë shisheje me mekanizëm sprucimi. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. **14. Solucion zbutës dhe aromatizues rrobash:** Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike të jetë solucion homogjen, me aromë parfumi. Vlera e PH nga 6.5 deri në 7.5. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ deri në 1.3 gr/cm³. Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Ambalazhimi në shishe plastike sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. **38. Letër për fshirjen e duarve e palosur z/v-Fold.** Letër higjienike duarsh për përdorim profesional me paketim z/v fold. Të jetë e përbërë nga celulozë e pastër me minimumi 2 shtresa dhe peshë specifike jo më pak se 15g/m². Pakoja të përmbajë jo më pak se 200 fije. Gjerësia e paketimit 10.5 ± 0.5 cm. Gjatësia e paketimit 21.5 ± 0.5 cm. Paketimi në pako me jo më pak se 200 fije me plastmas ose karton. Ngjyrë e bardhë. **40. Letër higjienike e paketuar rulon:** Të jetë me paketim min 10 rulon/pako. Të jetë e përbërë nga celulozë e pastër me minimumi 3 shtresa dhe peshë specifike jo më pak se 120 ndarje. Të jetë cilësore dhe e butë. Të jetë e tretshme në ujë. **42. Qese mbeturinash 30-40 liter** për koshat, me përmasa 35 ± 5cm x 35 ± 5cm, 30-40 litra, trashësia 20-30 micron, të jetë e paketuar në 10 fije. **43. Qese mbeturinash 40-50 liter** për koshat, me përmasa 50 ± 5cm x 60 ± 5cm, 40-50 litra, trashësia 20-30 micron, të jetë e paketuar në 10 fije. **44. Qese mbeturinash 70-80 liter** për koshat, me përmasa 60 ± 10cm x 80 ± 10cm, 70-80 litra, trashësia 20-30 micron, të jetë e paketuar në 10 fije. **45. Qese mbeturinash 100-120 liter** për koshat, me përmasa 80 ± 10cm x 100 ± 10cm, volumi 100-120 litra, trashësia 30-40 micron, të jetë e paketuar në 10 fije.

Duke qene se jemi nje kompani e vjeter ne treg persa i perket kesaj fushe veprimtarie, dhe pjesemarres ne procedura prokurimi prej vitesh kemi arritur ti njohim mire jo vetem kapacitetet e konkurenteve tane por edhe prodhuesit se ku ata furnizohen, duke patur keto njohuri ne kemi bindjen qe kriteri ne lidhje me mostrat per produktet e sipercituara nuk permbushet nga OE Euro Mega 2010 shpk, Anbim shpk dhe Besim Kamberi shpk, ne lidhje me kriterin 2.3.5 te DST autoriteti kontraktor ka kerkuar qellimi i paraqitjes se mostrave eshte qe autoriteti kontraktor te bindet qe produktet e ofertuara nga ana e operatoreve ekonomike te jene ne perputhje me specifikimet teknike te percaktuara nga ana e AK ne DST, pasi eshte e vetmja menyre verifikimi duke qene se pas ankesave te bera per kete procedure prane KPP nga kjo e fundit eshte vendosur te hiqen kriteret si MSDS e produkteve apo kataloget e produkteve, ateheret e vetmja mundesi e autoritetit kontraktor per te verifikuar nese specifikimet teknike te kerkuara do te plotesohen ishte kerkesa per paraqitjen e mostrave aq me teper qe pjesa me e madhe e produkteve jane me perberes kimikat, si produktet e renditura me siper nga numri rendor 1 deri ne 14, pra keto mostra duhet te kishin ne ambalazhin e tyre permbajtjen e specifikimeve teknike te kerkuara nga ana e autoriteti, pikerisht per kete fakt ne kemi dyshimet tona se mostrat e paraqitura per keto produkte nga keta operator ekonomik pra Euro Mega 2010 shpk, Anbim shpk si dhe Besim Kamberi shpk nuk kane ne etiketen e ambalazhit te produktit te pasqyruar asnje specifikim teknik te percaktuar nga ana e AK ne shtojcen 6, per kete arsye kerkojme nga ane KSHA dhe KPP te behet nje verifikim i ketyre mostrave, nese permbajne specifikimet teknike te kerkuara nga AK. Gjithashtu nga eksperiencia jone ne kete fushe kemi dyshimet dhe bindje se mostrat e dorezuara nga ana e ketyre operatoreve per artikujt nga nr.1 deri ne nr.14 nuk jane produkte reale te nje prodhuesi te vertet pse e themi kete dhe kjo eshte lehtesisht e verifikueshme, AK per keto produkte ne specifikimet teknike ka kerkuar nder te tjera qe te kete emertimin e markes tregëtare dhe barkodin e prodhimit te

fabrikes, ky percaktim nga ana e AK nuk eshte bere me kot, po me nje qellim te caktuar si garanci per AK qe keto produkte do te jene te prodhuara nga nje prodhues real dhe serioz. AK si rrjedhoje e ankesave prane KPP eshte detyruar te heq disa kriteret kualifikuese si autorizimi i prodhuesit, MSDS e artikujve, apo dhe kataloget, kriteret keto te cilat per AK ishin mjaft te rendesishme dhe garanci qe produktet do te ishin ne perputhje me specifikimet teknike. Pyetja qe lind ne keto kushte kur keto kriteret jane hequr, eshte sesi AK do te sigurohet qe mostrat e paraqitura dhe malli qe do te marre ne dorezim do te jete sipas specifikimeve teknike, e vetmja garanci qe AK ka ne keto momente eshte qe secili prej ketyre produkteve te kete ne etiketen e ambalazhit te specifikuar pervec emrit te produktet edhe specifikimet teknike, apo akoma me tej sikurse eshte kerkuar nga AK edhe barkodin e prodhuesit me qellim qe ne momentin qe do te skanohet barkodi automatisht skanimi te direkton ne faqen e prodhuesit kur ti mund te verifikosh se pari qe ky produkt eshte i prodhuar nga nje prodhues real dhe i vertet, ne kemi bindjen dhe dyshimin se nese do te beni nje prove duke skanuar barkodet e ketyre artikujve nese kane sepse pjesa me e madhe e tyre nuk kane barkod per tu skanuar por edhe ne se kane do te konstatoji se nuk ju adresojne askund pra nuk shfaqin se kush eshte prodhuesi real ne menyre qe te behet lidhja me marken tregtare te produktit. Pasi edhe qellimi i ligjvenesit ne nenin 40 pika 6 e VKM 285 eshte qe mostra e mallit, kerkohet kur AK e gjykon se kjo ka rendesi per vleresimin e ofertes teknike, dhe ne kete rast kur kriteret si autorizim prodhuesi, MSDS apo katalog produkti jane hequr, mostra mbetet e vetmja mundesi per te vetetuar permbushjen e specifikimeve teknike. [...]. Kerkojme qe te behet nje verifikim nese per artikujt mostra te sipercituara, a arrihet te behet verifikimi perberjes se artikullit me specifikimet teknike. Atehere persa kohe qe ligjvenesit ka percaktuar se eshte detyrim ligjor i subjektit ofertues te provoje me dokumentacion te plote dhe ne perputhje me kerkesat e autoritetit kontraktor, plotesimin e kriterëve te kerkuara ne dokumentet e tenderit, pasi ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto dokumente duhet te refuzohen si te papranueshme. Pikerisht ne kemi dyshime dhe bindje se operatorët ekonomik Euro Mega 2010 shpk, Anbim shpk, dhe Besim Kamberi PF, ne rastin konkret mostra e paraqitur prej tyre duhej te permbanin te dhena te plota mbi perberjen e artikullit ne permbushje te specifikimeve teknike. Pasi qellimi i AK per paraqitje te mostrave eshte nese ato permbushin specifikimet teknike ne perputhje me nenin 77 te ligjit 162/2020 “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar. Sepse vetem mbi bazen e permbushjes se specifikimeve teknike garantohet permbushja e cilesise se kerkuar. [...]. Gjithashtu kemi dyshimet tona se operatori Euro Mega 2010 shpk, Anbim shpk dhe Besim Kamberi PF, nuk ka dorezuar mostrat e duhura per produktet e kerkuara nga ana e autoritetit kontraktor konkretisht 42, 43, 44, 45, te cilat jane produkte qese plastike te kapaciteteve te ndryshme mbajtese, si dhe me permasa te ndryshme, ne asnje prej mostrave te ketyre 4 produkteve te cituara te dorezuara nga keta operatorë nuk evidentohet asnje specifik teknike, ne nuk arrijme te kuptojme se ku e gjen guximin KVO e AK qe ka pranuar si te rregullta keto mostra. Prandaj kerkojme ti kerkohet informacion AK dhe mostrat e dorezuara nga keta OE, ne menyre qe te konstatoji ju si KPP qe keto mostra nuk kane asnje te dhene nga ato te kerkuara nga AK as ne kuptim te permasave as te sasise mbajtese, pasi mostrat e dorzuara prej tyre dyshojme qe ne paketim nuk permbajne numrin e fijeve sipas etiketes, prandaj kerkojme nga KPP si institucion me i larte ne fushen e prokurimit publik te marre parasysh kete informacion dhe te merren masat e nevojshme per verifikimin e mostrave me specifikimet teknike te percaktuara nga ana e AK ne DST, pasi ne bindjen tone keto operator nuk kane derguar ditën e hapjes se ofertave

mostrat e kerkuara nga autoriteti kontraktor, pasi mostrat e dorzuar nuk kane lidhje fare me produktet qese plasmasi te kerkuara nga AK. Gjithashtu kerkojme qe te behet verifikim i mostres me nr rendor 38 te dorezuar nga ana e operatorit ekonomik Euro Mega 2010 shpk, nese produkti moster i dorezuar nga ky operator ka lidhje me produktin nr 38 te kerkuar nga AK, pasi kemi dyshime se ky OE nuk ka dorezuar jo vetem mostren e duhur pra ne vend qe te dorzonte Leter per fshirjen e duarve e palosur z/v-Fold, per kete produkt ka dorezuar si moster produkt ne forme tjeter por dhe specifikimet e kerkuara nga AK nuk jane ne perputhje me produktin e dorezuar nga ky OE per kete produkt. Bazuar ne ligjin e prokurimit publik, kerkojme nga KPP qe si institucion me i larte ne fushen e prokurimit publik te marre parasysht kete informacion dhe te merren masat e nevojshme per verifikimin e mostrave, nese ato jane ne perputhje me permbajtjen e kriterit 2.3.5 dhe me specifikimet teknike te kerkuara nga AK, qendrim ky tashme i mbajtur nga KPP ne vendimarrjen e saj si ne rastin e vendimit 370/2023; vendimit 1029/2025; dhe vendimit 1212/2025. **II.** Kundershtojme kualifikimin e ofertave te shoqerive “Euro Mega” shpk dhe “Anbim” shpk si dhe shtimin e arsyeve te skualifikimit per operatorin ekonomik “Besim Kamberi” pf te bere nga KVO-ja, si me poshte vijon: Autoriteti kontraktor ne dokumentat standarte te tenderit konkretisht ne kriterin 2.3.4 ka kerkuar 2.3.4. Operatori ekonomik ofertues per produktet objekt prokurimi me nr.1, 2, 3 ne tabelen e shtojces 7, duhet te paraqese dokumentin me te dhenat e sigurise (MSDS) te leshuara/publikuara nga prodhuesi/it dhe Certifikaten e Konformitetit CE (kur eshte e aplikueshme). Duke qene se jemi nje kompani e vjeter ne treg persa i perket kesaj fushe te veprimtarise dhe pjesemarres ne procedura prokurimi prej vitesh kemi arritur ti njohim mire jo vetem kapacitetet e konkurrenteve tane por edhe prodhuesit se nga ata furnizohen ndaj duke patur keto njohuri dhe duke ditur se per disa nga produktet e sipercituara konkretisht artikullin me nr rendor 1, 2, 3, duke qene se asnje nga keta 3 operatore ekonomik nuk eshte prodhues i ketyre tre produkteve, atehere kemi dyshime se keta OE nuk kane paraqitur MSDS e prodhuesit dhe Certifikaten e Konformitetit CE pasi referuar legjislacionit specifik per keto tre produkte eshte e detyrueshme dhe e aplikueshme Certifikata e Konformitetit CE, pasi eshte e veshtire qe te gjenden prodhues qe te leshojne MSDS dhe Certifikata e Konformitetit CE per keto artikuj, ndaj kerkojme nga ana juaj qe te beni nje verifikim ketyre MSDS per keto tre artikuj prane prodhuesve te deklaruar nga keta operator ekonomik ne kete procedure prokurimi nese jane leshuar vertet MSDS nga keta prodhues apo jo, pasi kemi dyshimet tona se keto OE nuk e permbushin kete kriter pasi MSDS dhe Certifikatate Konformitetit CE nuk jane te leshuara nga prodhuesit e deklaruar. Per sa thame me lart, kerkojme skualifikimin e OE Euro Mega 2010 shpk dhe Anbim shpk, si dhe lenien te skualifikuar per arsyet e shpallura nga KVO dhe shtimin e arsyeve te skualifikimit per operatorin ekonomik Besim Kamberi shpk ne kete procedure prokurimi”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, përcaktohet si më poshtë:

1	Solucion për larjen e dyshemesë. Të jetë i përshtatshëm për vende higjienike, dhoma zhveshje, palestra dhe kudo ku ka probleme arome të pakëndshme. Të jetë me veti të mira pastruese dhe aromatizuese. Gjendja fizike: të jetë solucion lëng, me aromë parfumi. Vlera e PH të jetë 5 deri në 10. Paraqitja fizike e solucionit të jetë homogjene. Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm ³ -1.1 gr/cm ³ . Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë jo më shumë se 10%. Ambalazhimi në shishe plastike. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
2	Detergjent për larje xhamash. Të jetë me efekt pastrimi dhe shkëlqim të xhamave. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjen, të ketë aromë parfumi. Vlera e PH 5 deri në 11. Përbërja të jetë homogjene dhe të ketë densitet 0.9 gr/cm ³ deri në 1.2 gr/cm ³ . Lënda tensioaktive të variojë nga 1.0% deri në 4.0%. Ambalazhimi në shishe plastikë me mekanizëm sprucimi .Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
3	Sapun i lëngshëm për duart. Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion viskoz dhe homogjen. Të mos jetë irritues me lëkurën e duarve. Vlera e PH jo më vogël se 5.5 dhe jo më e madhe se 8. Densiteti i lëngut të jetë 0.9 deri në 1.1 gr/cm ³ . Aromë parfumi. Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Lëndët tensioaktive të jenë nga 5% deri në 11%. Ambalazhimi nga fabrika në shishe plastike me mekanizëm në pjesën e trupit të shishes për manovrim të produktit gjatë përdorimit dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
4	Pluhur larës për rroba: të ketë aftësi vepruese dhe pastruese të larta. Pamja e jashtme: masë e pluhurizuar, e granular. Densiteti të jetë nga 0.6 gr/cm ³ deri në 1.1 gr/cm ³ . Vlera e pH të jetë 9 deri në 11. Tretshmëria në ujë të jetë jo më pak se 95% . Të përmbajë lagështi jo më shumë se 10%. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë 5% deri 15% dhe ≤5% për lëndët tensioaktive kationike dhe anionike. Aftësia shkumuese të jetë më e madhe se 5 cm. Ambalazhimi në qese plastike ose kuti kartoni sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
5	Acid për pastrim: të jetë solucion efikas në heqjen e kripërave të depozituara si dhe papastërtive. Zbardhës alkaline me aftësi vepruese dezinfektante. Të përmbajë në masën 12% deri në 30% acid klorhidrik. Vlera e pH 0-3. Densiteti i acidit të jetë 1.0 deri 1.5 gr/cm ³ . Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Ambalazhimi në bidona plastikë sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.

6	Solucion larës WC dezinfektues: Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizëm për pastrim më të thellë të anëve të ËC. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Vlera e pH të jetë jo më e madhe se 13 dhe tretshmëria në ujë të jetë 100%. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm ³ deri në 1.1 gr/cm ³ . Përmbajtja e klorit të jetë jo më e madhe se 3.5%.
7	Solucion për pastrimin e smërçit/kripërave nga hidrosanitare : për larje të lavamanit, sanitaret e tualetit, të pastrojë në thellësi kripërat e ujit nga hidrosanitare. Të parandalojë krijimin e kripërave. Të ketë aromë parfumi dhe substanca mbrojtëse për lëkurën e duarve. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjene. Vlera e PH jo më e madhe se 2.5 dhe jo më e vogël se 1.5. Të jetë i tretshëm në ujë. Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizëm sprucimi dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
9	Solucion kundra yndyrës: të ketë veti të mira pastruese në të gjitha sipërfaqet, të jetë në shishe plastike me mekanizëm sprucimi. Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion homogjen, të ketë aromë parfumi. Vlera e pH të jetë 10 deri në 14. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm ³ deri në 1.3 gr/cm ³ . Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Ambalazhimi në shishe plastikë me mekanizëm sprucimi dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
10	Solucion për pastrim të parketit: Gjendja fizike të jetë solucion homogjen, me arome parfumi. Vlera e PH nga 7 deri në 10. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm ³ deri në 1.3 gr/cm ³ . Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë me vlerë minimale jo më pak se 2.4 % dhe me vlerë maksimale jo më shumë se 5.5%. Ambalazhimi në bidona plastikë sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
11	Solucion larës enësh lëng: me efekt pastrimi të thellë. Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion homogjen dhe viskoze, të ketë aromë parfumi. Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Vlera e PH 6 deri në 10. Densiteti të variojë nga 0.9 gr/cm ³ deri në 1.2 gr/cm ³ . Lënda tensioaktive të jetë nga 15% deri në 20%. Ambalazhimi në shishe plastikë sipas kërkesave të autoritetit kontraktor Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
12	Solucion larës për mobilje: Me efekt pastrimi të njollave të forta dhe pluhurave tek mobiljet. Pastrues neutral me pak shkumë. Gjendja fizike e lëngut të jetë lëng homogjen, të ketë aromë parfumi. Densiteti të jetë nga 0.9 gr/cm ³ deri në 1.2 gr/cm ³ . Vlera e PH të jetë nga 6 deri në 7.5. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë jo më shumë se 7%. Ambalazhimi në shishe plastike sipas kërkesave të autoritetit kontraktor dhe me kokë shisheje me mekanizëm sprucimi. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.

14	Solucion zbutës dhe aromatizues rrobash: Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike të jetë solucion homogjen, me aromë parfumi. Vlera e PH nga 6.5 deri në 7.5. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm ³ deri në 1.3 gr/cm ³ . Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Ambalazhimi në shishe plastike sipas kërkesave të autoritetit kontraktor
38	Letër për fshirjen e duarve e palosur z/v-Fold. Letër higjienike duarsh për përdorim profesional me paketim z/v fold. Të jetë e përbërë nga celulozë e pastër me minimumi 2 shtresa dhe peshë specifike jo më pak se 15g/m ² . Pakoja të përmbajë jo më pak se 200 fije. Gjerësia e paketimit 10.5 ± 0.5 cm. Gjatësia e paketimit 21.5 ± 0.5 cm. Paketimi në pako me jo më pak se 200 fije me plastmas ose karton. Ngjyrë e bardhë.
40	Letër higjienike e paketuar rulon: Të jetë me paketim min 10 rulon/pako. Të jetë e përbërë nga celulozë e pastër me minimumi 3 shtresa dhe peshë specifike jo më pak se 120 ndarje. Të jetë cilësore dhe e butë. Të jetë e tretshme në ujë.
42	Qese mbeturinash 30-40 liter për koshat, me përmasa 35 ± 5cm x 35± 5cm, 30-40 litra, trashësia 20-30 micron, të jetë e paketuar në 10 fije.
43	Qese mbeturinash 40-50 liter për koshat, me përmasa 50 ± 5cm x 60± 5cm, 40-50 litra, trashësia 20-30 micron, të jetë e paketuar në 10 fije.
44	Qese mbeturinash 70-80 liter për koshat, me përmasa 60 ± 10cm x 80 ± 10cm, 70-80 litra, trashësia 20-30 micron, të jetë e paketuar në 10 fije.
45	Qese mbeturinash 100-120 liter për koshat, me përmasa 80 ± 10cm x 100± 10cm, volumi 100-120 litra, trashësia 30-40 micron, të jetë e paketuar në 10 fije.

III.1.2. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, pika 2.3.5 “Kapaciteti teknik e dokumentave të tenderit të publikuara në SPE, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kriterit si më poshtë vijon:

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostrat (kampionet) ditën e hapjes së ofertave, nga jo më pak se 1 (një) kampion për mallrat objekt prokurimi, për artikujt e kërkuar në shtojcën 7, përkatësisht me nr.rendor 1 deri në 20, 26, 28, 38, 40, 42, 43, 44, 45.

Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik.

- Mostra duhet të jetë për të gjithë artikujt e kërkuar, objekt i këtij prokurimi.
- Mostrat duhet të jenë të njëjta me ato të ofruara nga operatori ekonomik ofertues në dokumentacionin teknik të paraqitur në sistemin e publikimeve elektronike (SPE).

III.1.3. Komisioni Prokurimit Publik me qëllim shqyrtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues, me anë të shkresës nr. 2497/3 prot., datë 17.10.2025, i ka kërkuar

autoritetit kontraktor që të dërgojë pranë KPP-së mostrat e dorëzuara nga operatorët ekonomikë “Anbim” SHPK, “Euro Mega 2010” SHPK dhe “Besim Kamberi” PF pranë autoritetit kontraktor së bashku me dokumentacionin shoqërues të tyre. Me shkresën nr. 9134/1 prot, datës 22.10.2025, me objekt “Dërgim Mostra”, protokolluar me tonën me nr. 2497/4 prot., datë 22.10.2025, autoriteti kontraktor ka depozituar informacion, dokumentacion dhe mostrat e operatorëve ekonomik “Anbim” SHPK, “Euro Mega 2010” SHPK dhe “Besim Kamberi” PF sipas kërkesës nr. 2497/3 prot, datë 17.10.2025 të Komisionit Prokurimit Publik.

Konkretisht nga verifikimi i mostrave rezulton se operatori ekonomik “Anbim” SHPK ka paraqitur ndër të tjera edhe mostrat si më poshtë vijonë:





Konkretisht nga verifikimi i mostrave rezulton se operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK ka paraqitur ndër të tjera edhe mostrat si më poshtë vijonë:



III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

III.1.5. Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.6. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

- “1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.
- 2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.
- 3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

III.1.7. Në nenin 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...] 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.1.8. Në nenin 80 të Ligjit nr.162 date 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, parashikohet se:

“1. Kontratat jepen mbi bazën e kriterëve të përcaktuara, pasi autoriteti ose enti kontraktor të ketë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura;

b) operatori ekonomik, që ka dorëzuar ofertën, përmbush kriteret e kualifikimit e të përzgjedhjes dhe nuk ndodhet në ndonjë nga situatat që përbëjnë shkak për skualifikim.

2. Autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin refuzimin e ofertës, pavarësisht vlerës së saj, nëse vlerësohet se oferta e paraqitur nuk është në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit vendas, marrëveshjeve ndërkombëtare ose legjislacionit vendas në fushën e mjedisit, mbrojtjes shoqërore dhe punës.

3. Autoritetet ose entet kontraktore i shqyrtojnë ofertat e paraqitura bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga operatorët ekonomikë dhe legjislacionin përkatës në fuqi

4. Në çdo rast, nëse autoriteti ose enti kontraktor vihet në dijeni të një fakti që është kusht për skualifikimin e operatorit ekonomik të shpallur fitues, deri në momentin e lidhjes së kontratës merr vendim për skualifikimin e tij sipas parashikimeve në këtë ligj”

III.1.9. Në nenin 40 pika 6 germa a) “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose”.

III.1.10. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me kërkesat e dokumentave standarte të tenderit duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Referuar kriterit të veçantë të kualifikimit konkretisht kriterit 2.3.5 rezulton, se është kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë ofertues, duhet të paraqesin nga një mostër fizike për artikujt e kërkuar në shtojcen 7, përkatësisht me nr.rendor

1 deri në 20, 26, 28, 38, 40, 42, 43, 44, 45. Mostrat duhet të jenë të njëjta me ato të ofruara nga operatori ekonomik ofertues në dokumentacionin teknik të paraqitur në sistemin e publikimeve elektronike (SPE). Qëllimi i kërimit të mostrave është që autoriteti kontraktor të krijojë bindjen se mostrat e paraqitura janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”.

III.1.11. Referuar kriterit të veçantë të kualifikimit konkretisht pikës 2.3.5, si dhe shtojcës nr. 6 “Formulari Specifikimeve Teknike” rezulton se është kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë duhet të paraqesin nga një mostër për artikujt e kërkuar në shtojcën 7, konkretisht 1 deri në 20, 26, 28, 38, 40, 42, 43, 44, 45, në ditën dhe orën e hapjes së ofertave.

Nisur nga pretendimet e ankimuesit si dhe nga shqyrtimi i mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik “Anbim” SHPK dhe “Euro Mega 2010” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik, nga verifikimi i mostrave të dorëzuara nga AK rezulton se,

Operatori ekonomik “Anbim” SHPK ndër të tjera ka paraqitur artikujt mostra si më poshtë vijon:

Per Art 1. Solucion për larjen e dyshemesë. Të jetë i përshtatshëm për vende higjienike, dhoma zhveshje, palestra dhe kudo ku ka probleme arome të pakëndshme. Të jetë me veti të mira pastruese dhe aromatizuese. Gjendja fizike: të jetë solucion lëng, me aromë parfumi. Vlera e PH të jetë 5 deri në 10. Paraqitja fizike e solucionit të jetë homogjene. Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³-1.1 gr/cm³. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë jo më shumë se 10%. Ambalazhimi në shishe plastike. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Operatori ekonomik ka dorëzuar mostër ku konstatohet se solucioni është

Bril Rose Solucion për larje pllakash.

- Nga verifikimi i kësaj mostre rezulton se nuk përmbush specifikimet teknike përsa i përket PH, Tretshmerin, dhe Densitetin objekt ankimi, pra këto specifikime nuk gjejnë pasqyrim.

Per Art 2. Detergjent për larje xhamash. Të jetë me efekt pastrimi dhe shkëlqim të xhamave. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjen, të ketë aromë parfumi. Vlera e PH 5 deri në 11. Përbërja të jetë homogjene dhe të ketë densitet 0.9 gr/cm³ deri në 1.2 gr/cm³. Lënda tensioaktive të variojë nga 1.0% deri në 4.0%. Ambalazhimi në shishe plastikë me mekanizëm sprucimi .Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Operatori ekonomik “Anbim” SHPK ka paraqitur artikujt mostra si më poshtë vijon:

Epta For Glass & Smototh Surfaces

- Nga verifikimi i kësaj mostre rezulton se mostra e paraqitur i përmbush specifikimet teknike të sipërcituara për këtë produkt.

Per Art 3. Sapun i lëngshëm për duart. Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion viskoz dhe homogjen. Të mos jetë irritues me lëkurën e duarve. Vlera e PH jo më vogël se 5.5 dhe jo më e madhe se 8. Densiteti i lëngut të jetë 0.9 deri në 1.1 gr/cm³. Aromë parfumi. Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Lëndët tensioaktive të jenë nga 5% deri në 11%. Ambalazhimi nga fabrika në

shishe plastike me mekanizëm në pjesën e trupit të shishes për manovrim të produktit gjatë përdorimit dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Operatori ekonomik “Anbim” SHPK ka paraqitur artikujt mostra si më poshtë vijon:

Dolce Tenoro Sapun liquid

- Nga verifikimi i kësaj mostre rezulton se nuk përmbush specifikimet teknike përsa i përket Tretshmerin, objekt ankimi, pra ky specifikime nuk gjen pasqyrim.

Per Art 4. Pluhur larës për rroba: të ketë aftësi vepruese dhe pastruese të larta. Pamja e jashtme: masë e pluhurizuar, e granuluar. Densiteti të jetë nga 0.6 gr/cm³ deri në 1.1 gr/cm³. Vlera e pH të jetë 9 deri në 11. Tretshmëria në ujë të jetë jo më pak se 95% . Të përmbajë lagështi jo më shumë se 10%. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë 5% deri 15% dhe ≤5% për lëndët tensioaktive kationike dhe anionike. Aftësia shkumuese të jetë më e madhe se 5 cm. Ambalazhimi në qese plastike ose kuti kartoni sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Operatori ekonomik “Anbim” SHPK ka paraqitur artikujt mostra si më poshtë vijon:

Detersivo in Polvere pluhur automat

- Nga verifikimi i kësaj mostre rezulton se nuk përmbush specifikimet teknike përsa i përket Densitetit, objekt ankimi, pra ky specifikime nuk gjen pasqyrim.

Per Art5. Acid për pastrim: të jetë solucion efikas në heqjen e kripërave të depozituara si dhe papastërtive. Zbardhës alkaline me aftësi vepruese dezinfektante. Të përmbajë në masën 12% deri në 30% acid klorhidrik. Vlera e pH 0-3. Densiteti i acidit të jetë 1.0 deri 1.5 gr/cm³. Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Ambalazhimi në bidona plastikë sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Operatori ekonomik “Anbim” SHPK ka paraqitur artikujt mostra si më poshtë vijon:

Acido Muriarico

- Nga verifikimi i kësaj mostre rezulton se nuk përmbush specifikimet teknike përsa i përket Densitetit, PH, dhe Tretshmërinë, objekt ankimi, pra këto specifikime nuk gjen pasqyrim.

Per Art 6. Solucion larës WC dezinfektues: Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizëm për pastrim më të thellë të anëve të ËC. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Vlera e pH të jetë jo më e madhe se 13 dhe tretshmëria në ujë të jetë 100%. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ deri ne 1.1 gr/cm³. Përmbajtja e klorit të jetë jo më e madhe se 3.5%. Operatori ekonomik “Anbim” SHPK ka paraqitur artikujt mostra si më poshtë vijon:

Epta Zbardhues

- Nga verifikimi i kësaj mostre rezulton se nuk përmbush specifikimet teknike përsa i përket Densitetit, PH, Tretshmërinë, dhe Përmbajtjen e Klorit, objekt ankimi, pra këto specifikime nuk gjen pasqyrim.

Per Art 7. Solucion për pastrimin e smërçit/kripërave nga hidrosanitarët : për larje të lavamanit, sanitarët e tualetit, të pastrojë në thellësi kripërat e ujit nga hidrosanitarët. Të parandalojë krijimin e kripërave. Të ketë aromë parfumi dhe substanca mbrojtëse për lëkurën

e duarve. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjene. Vlera e PH jo më e madhe se 2.5 dhe jo më e vogël se 1.5. Të jetë i tretshëm në ujë. Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizem sprucimi dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Operatori ekonomik “Anbim” SHPK ka paraqitur artikujt mostra si më poshtë vijon:

Anticalc & Inoxy

- Nga verifikimi i kësaj mostre rezulton se nuk përmbush specifikimet teknike përse i përket PH, objekt ankimi, pra ky specifikime nuk gjen pasqyrim.

Per Art 8. Hipoklorit Natriumi (NaOCl 10-12%): ku përmbajtja e klorit aktiv të jetë 10-12%. Përmbajtja e alkalitetit jo më shumë se 5%, të mos ketë përmbajtje të lëndëve të ngurta, të ketë ngjyrë të verdhë deri në kafe të çelët, me erën karakteristike shpues në hundë. Ambalazhimi të jetë me bidona plastikë të përshtatshëm që ti rezistojnë efektit shpues të “klorit”. Ambalazhimi të jetë i etiketuar ku të paraqitet titulli i klorit aktiv. Të jetë cilësor. Operatori ekonomik “Anbim” SHPK ka paraqitur artikujt mostra si më poshtë vijon:

Hipoklorit Natriumi

- Nga verifikimi i kësaj mostre rezulton se mostra e paraqitur i përmbush specifikimet teknike të sipërcituara për këtë produkt.

Per Art 9. Solucion kundra yndyrës: të ketë veti të mira pastruese në të gjitha sipërfaqet, të jetë në shishe plastike me mekanizem sprucimi. Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion homogjen, të ketë aromë parfumi. Vlera e pH të jetë 10 deri në 14. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ deri në 1.3 gr/cm³. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Ambalazhimi në shishe plastikë me mekanizem sprucimi dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Operatori ekonomik “Anbim” SHPK ka paraqitur artikujt mostra si më poshtë vijon:

Super Sgrassatore Universale

- Nga verifikimi i kësaj mostre rezulton se mostra e paraqitur i përmbush specifikimet teknike të sipërcituara për këtë produkt.

Per Art 10. Solucion për pastrim të parketit: Gjendja fizike të jetë solucion homogjen, me arome parfumi. Vlera e PH nga 7 deri në 10. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ deri në 1.3 gr/cm³. Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë me vlerë minimale jo më pak se 2.4 % dhe me vlerë maksimale jo më shumë se 5.5%. Ambalazhimi në bidona plastikë sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Operatori ekonomik “Anbim” SHPK ka paraqitur artikujt mostra si më poshtë vijon:

Parquet

- Nga verifikimi i kësaj mostre rezulton se mostra e paraqitur i përmbush specifikimet teknike të sipërcituara për këtë produkt.

Per Art 11. Solucion larës enësh lëng: me efekt pastrimi të thellë. Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion homogjen dhe viskoze, të ketë aromë parfumi. Tretshmëria në ujë të jetë 100%.

Vlera e PH 6 deri në 10. Densiteti të variojë nga 0.9 gr/cm³ deri në 1.2 gr/cm³. Lënda tensioaktive të jetë nga 15% deri në 20%. Ambalazhimi në shishe plastike sipas kërkesave të autoritetit kontraktor Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Operatori ekonomik “Anbim” SHPK ka paraqitur artikujt mostra si më poshtë vijon:

Epta Lean

- Nga verifikimi i kësaj mostre rezulton se nuk përmbush specifikimet teknike përsa i përket Densitetit, objekt ankimi, pra ky specifikime nuk gjen pasqyrim.

Per Art 12. Solucion larës për mobilje: Me efekt pastrimi të njollave të forta dhe pluhurave tek mobiljet. Pastrues neutral me pak shkumë. Gjendja fizike e lëngut të jetë lëng homogjen, të ketë aromë parfumi. Densiteti të jetë nga 0.9 gr/cm³ deri në 1.2 gr/cm³. Vlera e PH të jetë nga 6 deri në 7.5. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë jo më shumë se 7%. Ambalazhimi në shishe plastike sipas kërkesave të autoritetit kontraktor dhe me kokë shisheje me mekanizëm sprucimi. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Operatori ekonomik “Anbim” SHPK ka paraqitur artikujt mostra si më poshtë vijon:

Parquet

- Nga verifikimi i kësaj mostre rezulton se mostra e paraqitur i përmbush specifikimet teknike të sipërcituara për këtë produkt.

Per Art 14. Solucion zbutës dhe aromatizues rrobash: Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike të jetë solucion homogjen, me aromë parfumi. Vlera e PH nga 6.5 deri në 7.5. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ deri në 1.3 gr/cm³. Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Ambalazhimi në shishe plastike sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Operatori ekonomik “Anbim” SHPK ka paraqitur artikujt mostra si më poshtë vijon:

Dumbo Profumo di Fiori

- Nga verifikimi i kësaj mostre rezulton se nuk përmbush specifikimet teknike përsa i përket PH, Densitetit dhe Tretshmërinë, objekt ankimi, pra ky specifikime nuk gjen pasqyrim.

Operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK ndër të tjera ka paraqitur artikujt mostra si më poshtë vijon:

Per Art 1. Solucion për larjen e dyshemesë. Të jetë i përshtatshëm për vende higjienike, dhoma zhveshje, palestra dhe kudo ku ka probleme arome të pakëndshme. Të jetë me veti të mira pastruese dhe aromatizuese. Gjendja fizike: të jetë solucion lëng, me aromë parfumi. Vlera e PH të jetë 5 deri në 10. Paraqitja fizike e solucionit të jetë homogjene. Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³-1.1 gr/cm³. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë jo më shumë se 10%. Ambalazhimi në shishe plastike. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Operatori ekonomik “Euro Mega 2010” ka dorëzuar mostër ku konstatohet se solucioni është

Lares Pllakash Euro Mega.

- Nga verifikimi i kësaj mostre rezulton se nuk përmbush specifikimet teknike përsa i përket PH, Tretshmerin, dhe Densitetin objekt ankimi, pra këto specifikime nuk gjejnë pasqyrim.

Per Art 2. Detergjent për larje xhamash. Të jetë me efekt pastrimi dhe shkëlqim të xhamave. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjen, të ketë aromë parfumi. Vlera e PH 5 deri në 11. Përbërja të jetë homogjene dhe të ketë densitet 0.9 gr/cm³ deri në 1.2 gr/cm³. Lënda tensioaktive të variojë nga 1.0% deri në 4.0%. Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizëm sprucimi .Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK ka paraqitur artikujt mostra si më poshtë vijon:

Solution Vetri

- Nga verifikimi i kësaj mostre rezulton se nuk përmbush specifikimet teknike përsa i përket PH, Lënd Tensioaktive, dhe Densitetin objekt ankimi, pra këto specifikime nuk gjejnë pasqyrim.

Per Art 3. Sapun i lëngshëm për duart. Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion viskoz dhe homogjen. Të mos jetë irritues me lëkurën e duarve. Vlera e PH jo më vogël se 5.5 dhe jo më e madhe se 8. Densiteti i lëngut të jetë 0.9 deri në 1.1 gr/cm³. Aromë parfumi. Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Lëndët tensioaktive të jenë nga 5% deri në 11%. Ambalazhimi nga fabrika në shishe plastike me mekanizëm në pjesën e trupit të shishes për manovrim të produktit gjatë përdorimit dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK ka paraqitur artikujt mostra si më poshtë vijon:

Sapun i Lëngëshëm Sweet Gardenia

- Nga verifikimi i kësaj mostre rezulton se nuk përmbush specifikimet teknike përsa i përket PH, Lënd Tensioaktive, Tretshmëri dhe Densitetin objekt ankimi, pra këto specifikime nuk gjejnë pasqyrim.

Per Art 4. Pluhur larës për rroba: të ketë aftësi vepruese dhe pastruese të larta. Pamja e jashtme: masë e pluhurizuar, e granuluar. Densiteti të jetë nga 0.6 gr/cm³ deri në 1.1 gr/cm³. Vlera e pH të jetë 9 deri në 11. Tretshmëria në ujë të jetë jo më pak se 95% . Të përmbajë lagështi jo më shumë se 10%. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë 5% deri 15% dhe ≤5% për lëndët tensioaktive kationike dhe anionike. Aftësia shkumuese të jetë më e madhe se 5 cm. Ambalazhimi në qese plastike ose kuti kartoni sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK ka paraqitur artikujt mostra si më poshtë vijon:

Euro Mega Washing Detergent

- Nga verifikimi i kësaj mostre rezulton se nuk përmbush specifikimet teknike përsa i përket PH, Tretshmëri, Lagështi dhe Densitetin objekt ankimi, pra këto specifikime nuk gjejnë pasqyrim.

Per Art 5. Acid për pastrim: të jetë solucion efikas në heqjen e kripërave të depozituara si dhe papastërtive. Zbardhës alkaline me aftësi vepruese dezinfektante. Të përmbajë në masën 12% deri në 30% acid klorhidrik. Vlera e pH 0-3. Densiteti i acidit të jetë 1.0 deri 1.5 gr/cm³. Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Ambalazhimi në bidona plastike sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK ka paraqitur artikujt mostra si më poshtë vijon:

Acido Muriarico

- Nga verifikimi i kësaj mostre rezulton se nuk përmbush specifikimet teknike përsa i përket Densitetit, PH, dhe Tretshmërinë, objekt ankimi, pra këto specifikime nuk gjen pasqyrim.

Per Art 6. Solucion larës WC dezinfektues: Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizëm për pastrim më të thellë të anëve të WC. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Vlera e pH të jetë jo më e madhe se 13 dhe tretshmëria në ujë të jetë 100%. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ deri në 1.1 gr/cm³. Përmbajtja e klorit të jetë jo më e madhe se 3.5%. Operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK ka paraqitur artikujt mostra si më poshtë vijon:

Euro Mega Solucion WC

- Nga verifikimi i kësaj mostre rezulton se nuk përmbush specifikimet teknike përsa i përket Densitetit, PH, Tretshmërinë, dhe Përmbajtjen e Klorit, objekt ankimi, pra këto specifikime nuk gjen pasqyrim.

Per Art 7. Solucion për pastrimin e smërçit/kripërave nga hidrosanitarët : për larje të lavamanit, sanitaret e tualetit, të pastrojë në thellësi kripërat e ujit nga hidrosanitarët. Të parandalojë krijimin e kripërave. Të ketë aromë parfumi dhe substanca mbrojtëse për lëkurën e duarve. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjene. Vlera e PH jo më e madhe se 2.5 dhe jo më e vogël se 1.5. Të jetë i tretshëm në ujë. Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizëm sprucimi dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK ka paraqitur artikujt mostra si më poshtë vijon:

Euro Mega Anticalcare Higjenizues – Dezinfektues - Aromatizues & Inoxe

- Nga verifikimi i kësaj mostre rezulton se nuk përmbush specifikimet teknike përsa i përket PH, objekt ankimi, pra ky specifikime nuk gjen pasqyrim.

Per Art 8. Hipoklorit Natriumi (NaOCl 10-12%): ku përmbajtja e klorit aktiv të jetë 10-12%. Përmbajtja e alkalitetit jo më shumë se 5%, të mos ketë përmbajtje të lëndëve të ngurta, të ketë ngjyrë të verdhë deri në kafe të çelët, me erën karakteristike shpuesë në hundë. Ambalazhimi të jetë me bidona plastikë të përshtatshëm që ti rezistojnë efektit shpues të “klorit”. Ambalazhimi të jetë i etiketuar ku të paraqitet titulli i klorit aktiv. Të jetë cilësor. Operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK ka paraqitur artikujt mostra si më poshtë vijon:

Euro Mega Hipoklorit Natriumi Naclo

- Nga verifikimi i kësaj mostre rezulton se nuk përmbush specifikimet teknike përsa i përket Përmbajtjes së Alkalitetit, objekt ankimi, pra ky specifikime nuk gjen pasqyrim.

Per Art 9. Solucion kundër yndyrës: të ketë veti të mira pastruese në të gjitha sipërfaqet, të jetë në shishe plastike me mekanizëm sprucimi. Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion homogjen, të ketë aromë parfumi. Vlera e pH të jetë 10 deri në 14. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ deri në 1.3 gr/cm³. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Ambalazhimi në shishe plastikë me mekanizëm sprucimi dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK ka paraqitur artikujt mostra si më poshtë vijon:

Euro Mega Sgrassatore Universale

- Nga verifikimi i kësaj mostre rezulton se nuk përmbush specifikimet teknike përsa i përket PH dhe Densiteti objekt ankimi, pra ky specifikime nuk gjen pasqyrim.

Per Art 10. Solucion për pastrim të parketit: Gjendja fizike të jetë solucion homogjen, me arome parfumi. Vlera e PH nga 7 deri në 10. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ deri në 1.3 gr/cm³. Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë me vlerë minimale jo më pak se 2.4 % dhe me vlerë maksimale jo më shumë se 5.5%. Ambalazhimi në bidona plastike sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK ka paraqitur artikujt mostra si më poshtë vijon:

Pastrues Parketi

- Nga verifikimi i kësaj mostre rezulton se nuk përmbush specifikimet teknike përsa i përket PH, Densiteti dhe Tretshmëria objekt ankimi, pra ky specifikime nuk gjen pasqyrim.

Per Art 12. Solucion larës për mobilje: Me efekt pastrimi të njollave të forta dhe pluhurave tek mobiljet. Pastrues neutral me pak shkumë. Gjendja fizike e lëngut të jetë lëng homogjen, të ketë aromë parfumi. Densiteti të jetë nga 0.9 gr/cm³ deri në 1.2 gr/cm³. Vlera e PH të jetë nga 6 deri në 7.5. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë jo më shumë se 7%. Ambalazhimi në shishe plastike sipas kërkesave të autoritetit kontraktor dhe me kokë shisheje me mekanizëm sprucimi. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK ka paraqitur artikujt mostra si më poshtë vijon:

Pastrues Mobiljesh

- Nga verifikimi i kësaj mostre rezulton se nuk përmbush specifikimet teknike përsa i përket PH, Densiteti dhe Lëndë Tensioaktive objekt ankimi, pra ky specifikime nuk gjen pasqyrim.

Per Art 14. Solucion zbutës dhe aromatizues rrobash: Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike të jetë solucion homogjen, me aromë parfumi. Vlera e PH nga 6.5 deri në 7.5. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ deri në 1.3 gr/cm³. Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Ambalazhimi në shishe plastike sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK ka paraqitur artikujt mostra si më poshtë vijon:

Livath Softener

- Nga verifikimi i kësaj mostre rezulton se nuk përmbush specifikimet teknike përsa i përket PH, Densitetit dhe Tretshmërinë, objekt ankimi, pra ky specifikime nuk gjen pasqyrim.

Komisioni thekson faktin se qëllimi i AK për paraqitje të mostrave është nëse ato përmbushin specifikimet teknike me të dhënat që përmbajnë artikujt objekt prokurimi në tërësi dhe ato të kërkuara për mostra në veçanti, në përputhje me nenin 77 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

Komisioni gjykon se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre sipas kërkesave dhe kriterëve të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit për sa kohë që i kanë pranuar ato.

Operatorët ekonomikë “Anbimi” SHPK dhe “Euro Mega 2010” SHPK nuk ka përmbushin kërkesat minimale siç janë përputhja e të dhënave të kërkuara në DST për artikujt që do të ofertojë, ndaj dhe të dhënat që përmbajnë artikujt paraqitur si mostra nga këta operatorë ekonomikë duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike.

Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me Dokumentet e tenderit dhe nga ana tjetër është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Në përfundim të konstatimit të fakteve Komisioni gjykon se operatori ekonomik “Anbim” SHPK dhe “Euro Mega 2010” SHPK nuk plotësojnë kriteret për kualifikim, në lidhje me paraqitjen e mostrave në përputhje me specifikimet teknike në këtë procedurë.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Malvina Visoka” PF qëndrojnë pjesërisht.

III.2. Në lidhje me pretendimet e tjera të ankimuesit për operatorin ekonomik “Anbim” SHPK dhe “Euro Mega 2010” SHPK, Komisioni gjykon se nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi, referuar gjykimit mësipërm në pikën III.1.11 rezulton se këta operatorë ekonomik nuk përmbush specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim, ndaj dhe gjendja faktike dhe juridike e tyre do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura e prokurimit, objekt shqyrtimi, duke përmbushur qëllimin e ankimuesit “Malvina Visoka” P.F.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Malvina Visoka” PF mbi operatorin ekonomik “Besim Kamberi” PF, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, fati i kësaj shoqërie është përcaktuar tashmë prej vendimit të KVO-së të datës 08.09.2025, ku kjo shoqëri rezulton e skualifikuar nga kjo procedurë prokurimi, e për rrjedhojë pa asnjë ndikim në interesat e ankimuesit. Për më tepër, nga verifikimi i informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, si dhe nga shqyrtimi administrativ në KPP, nuk rezulton që ky operator ekonomik të jetë ankimuar në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik “Malvina Visoka” PF mbi operatorin ekonomik “Besim Kamberi” PF nuk do të merret në shqyrtim.

III.4. Lidhur me pretendimet e të operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK për shoqërinë “Anbim” SHPK Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se:

III.4.1 Parashikimi i nenit 110 e vijues të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kërkohet shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Sa më sipër KPP gjykon se është e nevojshme të ndalet në

elementët e testit të legjitimitetit në një procedurë ankimi përpara KPP. Këto elementë janë *interesi* i ankuesit, *dëmi real ose potencial i pritshëm* dhe ekzistenca e një vendimi të një autoriteti kontraktor *i marrë në kundërshtim me ligjin*.

III.4.2. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që, përmes ankimit në KPP, ai të fitojë kontratën. Edhe në hipotezën, se pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimesi sërisht nuk do të ishte fitues i kontratës, për sa kohë që përpara tij me vlerë më të ulët vijon të qëndrojë i kualifikuar një operator ekonomik edhe pas ankesës së bërë prej tij. Pra, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real nuk ka se si të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi. Pasi për sa kohë që pas shqyrtimit të pretendimeve të OE “*Malvina Visoka*” PF mbi s’kualifikimin e operatorit ekonomik “*Euro Mega 2010*” SHPK, qendrojnë, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se gjendja faktike juridike e operatorit ekonomik “*Euro Mega 2010*”, SHPK do të vijojë të mbetet e skualifikuar, ndaj dhe pretendimet e operatorit “*Euro Mega 2010*” SHPK për s’kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “*Anbim*” SHPK në procedurën e prokurimit, në rastin konkret, nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ, pasi cilido qoftë fati i pretendimeve të tij, për këtë operator ekonomik pala ankuese “*Euro Mega 2010*” SHPK nuk mund të arrijë dot qëllimin e saj final të fitimit të kontratës, pasi do të mbetet e skualifikuar.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*Malvina Visoka*” PF në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-51165-06-13-2025 me objekt “*Blerje mjete pastrimi*” me fond limit 12,583,334 (*dymbëdhjetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e katër*) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 22.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.
2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*Euro Mega 2010*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-51165-06-13-2025 me objekt “*Blerje mjete pastrimi*” me fond limit 12,583,334 (*dymbëdhjetë milion e*

pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e katër) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 22.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Anbim” SHPK dhe “Euro Mega 2010” SHPK, si dhe të korrigjojë shkeljet duke i skualifikuar ato.
4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Malvina Visoka” PF.
6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

